


UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME
SPECIALIZIM NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



TEZA MASTER

**Efektet e studimeve nga distanca përmes platformave tek
studentët e nivelit master të Teknologjisë me TIK dhe
Matematikë**

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Sylejman Berisha

Kandidatja:

Sofije Shkodra

Prishtinë, Janar, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"

FAKULTETI I EDUKIMIT

**PROGRAMI: MASTER I MËSIMDHËNIES LËNDORE ME
SPECIALIZIM NË TEKNOLOGJI DHE TIK**



TEZA MASTER

**Efektet e studimeve nga distanca përmes platformave tek
studentët e nivelit master të Teknologjisë me TIK dhe
Matematikë**

Mentori:

Prof.Asoc.Dr. Sylejman Berisha

Kandidatja:

Sofije Shkodra

Prishtinë, Janar, 2022

© 2022 – *Sofije Shkodra*

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ABSTRAKTI

Procesi i zhvendosjes së studimeve në formatin në distancë ose online për shkak të masave parandaluese ndaj përhapjes së virusit Covid-19 është bërë tanimë pjesë e shumë institucioneve edukative arsimore.

Përmes këtij hulumtimi paraqitet mësimdhënia dhe të nxënimit në një mënyrë krejt tjetër nga ajo që kemi parë deri më tani. Studimi në distancë është formë e arsimit, e cila realizohet përmes teknologjive moderne të komunikimit, me qëllim të mësuarit e studentëve të vendosur në vende dhe largësi të ndryshme jashtë ambientit tradicional të studimit (klasës).

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është që të shqyrtohen dhe hulumtohen efektet pozitive dhe negative të studimeve nga distanca që po realizohen duke i përdorur platformat **Google Meet** dhe **Google Classroom**, si dhe platforma të tjera tek studentët e nivelit master, dhe sa janë të kënaqur profesorët dhe studentët me arritje të tyre.

Hulumtimi është realizuar me anë të metodologjisë sasiore dhe cilësore. Për mbledhjen e të dhënave kemi përdorur pyetësorët që janë përpiluar për studentët dhe intervistat për profesorët e Fakultetit të Edukimit nga Programet “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK” si dhe “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë” nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”. Numri i studentëve të cilët kanë marr pjesë në plotësimin e pyetësorit është 72, 19 student nga viti i dytë i studimeve dhe 53 student nga viti i parë i studimeve. Ndërsa i kemi intervistuar 3 profesor nga programi “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK” dhe 2 profesor nga programi “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë”.

Nga hulumtimi kemi arritur në përfundim se efektet e studimeve nga distanca nuk janë në nivel të mirë. Studentët dhe profesorët e pranojnë se studimi nga distanca ka efekte pozitive, por gjithashtu nuk mungojnë edhe efektet negative.

Fjalët kyçe: studimi në distancë, studentët, profesorët, platformat, sfidat

ABSTRACT

The process of shifting studies to distance or online format due to preventive measures against the spread of Covid-19 virus has already become part of many educational institutions.

Through this research, teaching and learning is presented in a completely different way from what we have seen so far. Distance learning is a form of education, which is realized through modern communication technologies, in order to teach students located in different places and distances outside the traditional study environment (classroom).

The main purpose of this research is to examine and research the positive and negative effects of distance studies that are being carried out using the **Google Meet** and **Google Classroom** platforms, as well as other platforms for master students, and how satisfied are the professors and students with their achievements.

The research was conducted through quantitative and qualitative methodology. Questionnaires that have been compiled for students and interviews for professors of the Faculty of Education from the programs “Master of subject teaching with specialization in Technology and ICT” and “Master of subject teaching with specialization in Mathematics” from the University of Prishtina “Hasan Prishtina” are planned to be used for data collection. The number of students who participated in completing the questionnaire is 72, 19 students from the second year of studies and 53 students from the first year of studies. While we interviewed 3 professors from the program “Master of subject teaching with specialization in Technology and ICT” and 2 professors from the program “Master of subject teaching with specialization in Mathematics”.

From the research we have concluded that the effects of distance studies are not at a good level. Students and professors acknowledge that distance learning has positive effects, but there are also negative effects.

Keywords: distance learning, students, professors, platforms, challenges

FALËNDERIMI

Në radhë të parë falënderoj Zotin që më dha shëndetin dhe mundësinë që të përfundoj studimet master, pastaj e falënderoj nënën time, atë që më ka qëndruar çdo sekondë pranë duke më udhëhequr me vullnet që unë të arrija këtë ditë, gjithashtu falënderoj gjithë familjen time, e cila më ka qëndruar pranë në çdo hap të jetës.

Falënderime të veçanta kam për mentorin tim Prof. Asoc. Dr. Sylejman Berisha për kontributin dhe mbështetjen e tij gjatë studimeve, e çmoj shumë për durimin që pati për diskutimet, këshillat dhe rekomandimet që m'i dha për ta përfunduar punimin e tezës së masterit.

Ndjej nevojën për të falënderuar të gjithë stafin e profesorëve të Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishinës “Hasan Prishtina”, në mënyrë të veçantë të Departamentit të Teknologjis me TIK, të cilët me punë dhe pasion përcollën tek unë, përgjatë dy viteve të nivelit Master, njohuritë e nevojshme për tu zhvilluar dhe formuar intelektualisht.

Veç të tjerave, u jam mirënjohëse të gjithë mësimitdhënësve që më kanë dhënë fillet e para të dijeve dhe që besuan se në të ardhmen, sot, do të isha kjo që jam.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, falënderoj të gjithë kolegët për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme.

PËRMBAJTJA

| | |
|--|-----------|
| Lista e figurave | vii |
| Lista e grafikëve | ix |
| Lista e tabelave | x |
| Lista e shkurtesave..... | x |
| 1. Hyrje..... | 1 |
| 1.1. Definimi i problemit | 1 |
| 1.2. Qëllimi i hulumtimit..... | 2 |
| 1.3. Pyetjet e hulumtimit..... | 2 |
| 1.4. Hipoteza e hulumtimit | 2 |
| 2. SHQYRTIMI I LITERATURËS | 3 |
| 3. TË MËSUARIT NGA DISTANCA..... | 5 |
| 3.1. Mësimi Sinkron dhe Asinkron | 5 |
| 3.2. Llojet e edukimit në distancë | 6 |
| 3.3. Si funksionon mësimi në distancë | 6 |
| 3.4. Cilat janë avantazhet e mësimit në distancë? | 6 |
| 3.5. Disavantazhet e mësimit në distancë | 8 |
| 4. GOOGLE CLASSROOM..... | 9 |
| 4.1. Historiku i Google Classroom | 9 |
| 4.2. Çfarë është Google Classroom | 9 |
| 4.2.1. A është Google Classroom një LMS?..... | 10 |
| 4.3. Kush mund ta përdorë Google Classroom?..... | 10 |
| 4.4. Në cilat pajisje punon Google Classroom? | 10 |
| 4.5. Çfarë mundëson Google Classroom | 11 |
| 4.6. A mund ta përdorin profesorët Google Classroom për vlerësime dhe notime? | 12 |
| 4.7. Si mund ta mbështesë Google Classroom mësimdhënien e diferencuar? | 12 |

| | | |
|---------|---|----|
| 4.8. | Avantazhet e Google Classroom në edukim | 13 |
| 4.9. | Disavantazhet e Google Classroom në edukim..... | 14 |
| 3.10. | Krijimi i llogarisë në Google Classroom..... | 15 |
| 3.10.1. | Si të krijoni një klasë virtuale në Google Classroom si profesor | 17 |
| 4.10.2. | Antarësimi në një klasë virtuale dhe përdorimi i Google Classroom për studentët | 28 |
| 5. | GOOGLE MEET | 32 |
| 5.1. | Historiku i Google Meet | 32 |
| 5.2. | Çka është Google Meet..... | 32 |
| 5.3. | Avantazhet e Google Meet..... | 32 |
| 5.4. | Disavantazhet e Google Meet..... | 33 |
| 5.5. | Krijimi i një llogari në Google Meet | 34 |
| 5.5.1. | Krijimi i një takimi nga shfletuesi..... | 34 |
| 5.5.2. | Krijimi i një takimi përmes email-it..... | 37 |
| 5.5.3. | Caktimi i një takimi përmes Google Calendar..... | 38 |
| 5.5.4. | Si ta përdorni Google Meet nga telefoni | 40 |
| 5.5.5. | Krijimi i një takim në Google Meet nëpërmjet Google Classroom..... | 42 |
| 5.6. | Video Konferenca / Klasa e drejtpërdrejtë duke përdorur Google Meet..... | 44 |
| 5.6.1. | Google Meet Settings | 48 |
| 5.6.2. | Present now..... | 56 |
| 5.6.3. | Rejoin Meeting (Bashkohu përsëris në takim)..... | 59 |
| 6. | METODOLOGJIA E HULUMTIMIT..... | 60 |
| 6.1. | Dizajnimi i hulumtimit..... | 60 |
| 6.2. | Populacioni dhe mostra | 60 |
| 6.3. | Instrumentet | 61 |

| | |
|---|------------|
| 6.4. Procedurat..... | 61 |
| 7. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET | 62 |
| 7.1. Rrezultatet nga pyetësorët me studentët | 63 |
| 7.2. Rezultatet nga intervista me profesorët..... | 78 |
| 7.3. Testimi i hipotezave..... | 87 |
| 8. DISKUTIMI DHE KONKLODIMET | 90 |
| REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE | 94 |
| SHTOJCA A: PYETËSORI PËR STUDENTË..... | 97 |
| SHTOJCA B: INTERVISTA PËR PROFESOR..... | 100 |

Lista e figurave

| | |
|--|----|
| Figura 1. Krijimi i Llogaris në Google | 16 |
| Figura 2. Krijimi i llogarisë në Google Classroom..... | 17 |
| Figura 3. Mundësia për krijim të klasës apo bashkim në klasë | 18 |
| Figura 4. Plotësimi i të dhënave për krijimin e një klase..... | 18 |
| Figura 5. Krijimi i klasës “Teknologji me Tik – Klasa e tetë” | 19 |
| Figura 6. Mënyra si të postoni në klasë për studentët tuaj..... | 20 |
| Figura 7. Kodi për bashkangjtitjen e nxënësve/studentëve në klasë..... | 21 |
| Figura 8. Ndryshimi i pamjes së klasës | 21 |
| Figura 9. Menyja Classwork..... | 22 |
| Figura 10. Butoni “Create” | 22 |
| Figura 11. Faqja për krijimin e një detyre..... | 23 |
| Figura 12. Krijimi i detyrës për studentë | 24 |
| Figura 13. Class Drive polder | 25 |
| Figura 14. Menyja People | 26 |
| Figura 15. Menyja “Grades” | 27 |
| Figura 16. Pamja e klasë nga studentët..... | 29 |
| Figura 17. Pamja e detyrës tek studentët | 30 |

| | |
|---|----|
| Figura 18. Pamja “View assignment” | 30 |
| Figura 19. Pamja fillestare e Google Meet në Ueb | 34 |
| Figura 20. Pamja pas logimit me llogari të Google-së në Google Meet..... | 35 |
| Figura 21. Qasja në Google Meet direkt nga Shfletuesi | 36 |
| Figura 22. Mënyra për krijimin e një llogarit e Google Meet nga email-i..... | 37 |
| Figura 23. Krijimi i një takimi përmes email-it | 38 |
| Figura 24. Bashkimi në takim përmes email-it..... | 38 |
| Figura 25. Qasja në Google Calendar | 39 |
| Figura 26. Hapja e faqes Google Calendar | 39 |
| Figura 27. Instalimi i Google Meet në telefon..... | 41 |
| Figura 28. Hapja e aplikacionit Google Meet në telefon | 41 |
| Figura 29. Class Settings..... | 42 |
| Figura 30. Enable Meet Link | 42 |
| Figura 31. Kopijimi i linkut të Google Meet | 43 |
| Figura 32. Paraqitja e linkut të Google Meet e dukshme për studentët | 43 |
| Figura 33. Paraqitja e linkut në faqen kryesore të kursit | 44 |
| Figura 34. Pamja e takimit në Google Meet pasi mësimdhënësi klikon në link..... | 44 |
| Figura 35. Pamja e takimit në Google Meet pasi studenti klikon në link..... | 45 |
| Figura 36. Informacioni për ftimin e studentëve në takim..... | 45 |
| Figura 37. Shtimi i pjesëmarrësve në takim..... | 46 |
| Figura 38. Ftesa për pjesëmarrje në takim | 46 |
| Figura 39. Shikimi i numrit të personave në takim..... | 47 |
| Figura 40. Lista e personave aktiv në takim | 47 |
| Figura 41. Mundësi për të shkëmbyer mesazhe në Google Meet | 48 |
| Figura 42. Dërrasa e bardhë | 49 |
| Figura 43. Hapja e dërrasës së bardhë | 49 |
| Figura 44. Zgjedhja e tabelave të ruajtura | 50 |
| Figura 45. Opsioni Change layout | 50 |
| Figura 46. Opsionet e layout-it | 51 |
| Figura 47. Opsioni “Full Screen”..... | 51 |
| Figura 48. Aktivizimi i ekranit të plotë..... | 52 |

| | |
|--|----|
| Figura 49. Opsioni “Captions” | 52 |
| Figura 50. Opsionet për zgjedhjen e gjuhës | 53 |
| Figura 51. Aktivizimi i titrave | 53 |
| Figura 52. Çaktivizimi i titrave | 54 |
| Figura 53. Raportimi i një problemi | 54 |
| Figura 54. Audio/video settings | 55 |
| Figura 55. Audio settings | 55 |
| Figura 56. Video settings | 56 |
| Figura 57. Opsioni Present now | 56 |
| Figura 58. Present now – Windows selection | 57 |
| Figura 59. Ndarja e një dritarje | 57 |
| Figura 60. Ndarja e një dritareje nga Chrome | 58 |
| Figura 61. Ndarja e dritarë nga chrome | 58 |
| Figura 62. Bashkohu përsëris në takim | 59 |

Lista e grafikëve

| | |
|--|----|
| Grafiku 1. A ishin studentët e pajisur me pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online? | 63 |
| Grafiku 2. A kishin studentët lidhje të qëndrueshme interneti për mbajtjen e studimeve nga shtëpia? | 64 |
| Grafiku 3. Cilat pajisje i kanë përdorur studentët për zhvillimin e mësimit online? | 65 |
| Grafiku 4. A kishin studentët vështirësi në përdorimin e platformave? | 66 |
| Grafiku 5. Përdorimi i platformave të ndryshme nga studentët. | 67 |
| Grafiku 6. A kishin studentët hapësirë të qetë për ndjekjen e mësimit nga shtëpia? | 68 |
| Grafiku 7. Cila është forma e mësimit online e praktikuar më së shpeshti? | 69 |
| Grafiku 8. A kanë shpenzuar studentët më tepër kohë në kryerjen e obligimeve? | 70 |
| Grafiku 9. Efektet pozitive të mësimit online. | 71 |
| Grafiku 10. Efektet negative të mësimit online. | 73 |
| Grafiku 11. Sa efektiv është mësimi online? | 75 |
| Grafiku 12. Si e kanë versuar studentët cilësinë e mësimit online? | 76 |
| Grafiku 13. Vlersimi i studentëve për aftësitë e profesorëve në përdorimin e mjeteve digjitale. .. | 77 |

Lista e tabelave

| | |
|--|----|
| Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve..... | 61 |
| Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë | 61 |
| Tabela 3. Ndryshimi i mesatareve të Programeve | 87 |
| Tabela 4. Analiza e të dhënave nga testi i pavarur i mostrave T-Test | 88 |
| Tabela 5. Ndryshimi i mesatareve të programeve | 89 |
| Tabela 6. Analiza e të dhënave nga testi i pavarur i mostrave T-Test | 89 |

Lista e shkurtesave

TIK – Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

IT – Information Technology

LMS - Sistem i pavarur i menaxhimit të mësimin

CMS - Sistem i menaxhimit të kursit

SIS - Sistem i informacionit të studentit

SPSS – Statistical Package for the Social Sciences

PC – Personal Computer

1. Hyrje

Bota në të cilën po jetojmë është rezultat i ndryshimeve të vazhdueshme. Ndryshimet për të cilat jemi dëshmitar të gjithë, përfaqësojnë një periudhë domethënëse në jetën tonë. Këto ndryshime kanë qenë teknologjike në natyrën e tyre. Përdorimi i teknologjisë u konsiderua si alternativa më e përshtatshme dhe e vetme për t'i mbajtur funksionale sistemet arsimore duke kontribuar në parandalimin e pandemis Covid-19.

Sipas Blurton, TIK përcaktohet si “Një grup i larmishëm i teknologjive, mjeteve dhe burimeve të përdorura për të komunikuar, krijuar, shpërndarë, ruajtur dhe menaxhuar informacionin”. Këto teknologji përfshijnë kompjuterët, internetin, radio, TV, etj.

Duke përfshirë TIK-un në edukim nënkuptojmë se po përfshijmë të gjitha llojet e teknologjisë, të cilat përdoren për të shfrytëzuar dhe manipuluar informacionin. TIK-u në edukim përdoret si një implementim i pajisjeve dhe mjeteve teknologjike në procesin mësimorë për të regjistruar dhe përpunuar informacionet në formë digjitale.

Pandemia ka sjellë një model të ri të të mësuarit, të mësuarit online apo nga distanca, e cila mundësohet nga përdorimi i TIK-ut dhe mjeteve të saj. Përmes kësaj, profesorët dhe studentët po mësojnë mënyra inovative në procesin arsimorë. TIK-u ka mundësuar që përmes tij arsimit të arrihet në çdo cep të botës madje edhe në zona të thella, pavarësisht se ku ndodhen studentët, dhe ka siguruar që çdo student të përfitoj nga ai.

Forma e të mësuarit online apo nga distanca njihet me emrin “Platformë”. Përmes këtyre platformave mund të realizohet ora mësimore në mënyrë interesante dhe interaktive. Një platformë mësimi është një grup shërbimesh interaktive në internet që u jep studentëve qasje në informacion, mjete dhe burime për të mbështetur shpërndarjen arsimore dhe menaxhimin përmes internetit. Platformat e të mësuarit zakonisht quhen mjedise virtuale të të mësuarit (VLE), sisteme për menaxhimin e mësimit (LMS) ose sistemet e menaxhimit të përmbajtjes së të mësuarit (CLMS).

1.1. Definimi i problemit

E ardhmja e cilësisë së arsimit varet jashtëzakonisht shumë nga cilësia e mësimdhënies në institucionet arsimore. Mënyra se si po realizohet mësimdhënia dhe mësimnxënia nga distanca tek studentët e nivelit master është njëra nga pyetjet e hulumtimit. Në këtë hulumtim kërkohet

shqyrtimi i problemit rreth çështjes se sa ndikon në mësimdhënie efekti i përdorimit të sistemeve të menaxhimit të mësimi virtual. Njëashtu, është vlerësuar menaxhimi i studimit në distancë duke përdorur platformat Google Classroom dhe Google Meet. Nga ky hulumtim ne kemi kuptuar cilat janë të mirat dhe mangësit që i sjell të mësuarit nga distanca.

1.2. Qëllimi i hulumtimit

Ky hulumtim ka për qëllim që të shqyrtoj dhe hulumtoj efektet pozitive dhe negative të studimeve nga distanca, që po realizohen duke përdorur platformat Google Classroom, Google Meet dhe platforma të tjera.

1.3. Pyetjet e hulumtimit

Pyetja kryesore e hulumtimit është:

1. Çfarë efekte ka studimi nga distanca përmes platformave tek studentët e nivelit mastër?

Pyetjet ndihmëse të hulumtimit janë:

- a) Sa posedojnë studentët njohuri dhe kushte të mjaftueshme për mbajtje të mësimi nga distanca?
- b) A kanë profesorët nivel të duhur të përgatitjes për mësimdhënie nga distanca?
- c) Sa është niveli i interesimit për mësimënxënie tek studentët në këto rrethana?

1.4. Hipoteza e hulumtimit

Hipoteza kryesore:

- ✓ Efekti i studimeve nga distanca është në nivel të mirë, përkundër mospërgatitjes paraprake të profesorëve.

Hipoteza ndihmëse:

- ✓ Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimorë nga distanca.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Edukimi në distancë nuk është një fenomen i ri pasi që aktualisht ka qenë në dispozicion që nga viti 1700. Forma e parë e arsimit në distancë ishte modeli i shkollës me korrespondencë, i cili tashmë ka evoluar në një formë elektronike për të ofruar arsimin në distancë (Harting & Erthal).

Të njëjtit faktorë të cilët ndërlidhen me perspektivën e profesorëve për metodologjinë e mësimdhënies të cilët është vërtetuar të ndikojnë në nivelin e integritit të teknologjisë në klasë, parashihet të kenë ndikim gjithashtu në realizimin e suksesshëm të mësimin online meqë zhvendosja e mësimin nga institucioni në formatin online ngërthen në vete konceptin i cili quhet “mësimi fleksibil”. Sipas këtij koncepti, përkundër se mësimi zhvendoset në versionin online, duhet të jetë i atillë që stimulon të nxënësit tek studentët dhe se kurset duhet të jenë të dizajnuara me synim mbështetjen e nevojave individuale të tyre (Huang, et al., 2020).

Suksesi i realizimit të mësimin në distancë ose online, si dhe menaxhimi me sukses i ndryshimeve, është vërtetuar të ndikohet nga mënyra e ofrimit të instruksioneve dhe niveli i sqarimit të tyre, qasja dhe përshtatshmëria e pajisjeve teknologjike, koha, motivimi dhe mbështetja për të marrë pjesë në mësimin online (Ibrahim, Al-Kaabi, & El-Zaatari, 2013).

Studentët në kurset online janë më të lehtësuar nga presioni i monitorimit dhe gjykimit pasi ata zhyten në një mjedis parisk, në të cilin mund të provojnë gjëra të reja dhe mund të gabojnë pa u ekspozuar së jashtmi. Ndryshe nga ç’ndodh në klasë, këtu ata nuk do të gjykohen dhe nuk u testohet drejtpërdrejt vëmendja, memoria apo kapaciteti konjitiv (FAO, 2011).

Një profesor, duke përdorur çdo lloj LMS-i, duhet të jetë në gjendje të përgatisë dhe menaxhojë përmbajtjen arsimore në format elektronik, si dhe të lejojë studentët të përdorin materialet e kursit dhe të monitoroj performancën e tyre (Ellis, 2009).

E gjithë bota është angazhuar papritmas në eksperimentin më të madh të mësimin në distancë në histori. Teknologjia nuk është më një instrument periferik e cila është mirë të jetë që ta bëjë arsimin më efikas dhe efektiv. Por ajo tani është mediumi thelbësor që lejon që arsimi të vazhdojë mes krizës. Deri më tani teknologjia ka qenë mjet ndihmës në arsim. Tani, papritmas arsimi varet nga teknologjia (Diaz & Lee, 2020).

e-Learning është një metodë efektive dhe e realizueshme e mësimdhënies, dhe i ndihmon studentët të ulin kostot, të kursejn kohë dhe të zhvillojnë aftësit e tyre digjitale dhe aftësit për të mësuar gjatë gjithë jetës (Nguyen, 2019).

Me Google Classroom studentët mund t'i bashkohen klasave të ndryshme në kohë të dëshiruar duke kursyer kohë për t'u përqendruar në të mësuarit. Profesorët mund të ndajnë literaturën me studentët, njoftimet, detyrat të gjitha online në një web shfletues. Të gjitha klasat kanë transmetimin e tyre për të bashkëpunuar dhe për të shkëmbyer ide me shokët e klasës. Detyrat mund të ruhen, plotësohen dhe dorëzohen në sistem (Universiteti "Nënë Tereza", 2018).

Google Meet mundësoi që profesorët dhe studentët në të gjithë botën të mund të komunikojnë dhe mësojnë lehtësisht, pavarësisht nga vendodhja e tyre. Si një profesor ju mund të planifikoni dhe të krijoni takime në Google Meet dhe të mbani orët tuaja ashtu siç do ti realizonit në një mjedis normal në klasë (NEO, 2021).

Edukimi në distancë përcaktohet si një metodë e mësimdhënies ku studenti dhe profesori janë të ndarë fizikisht. Të cilët shfrytëzojnë një kombinim të teknologjive, si letërkëmbimin, audion, videon, kompjuterit dhe internetin (Roffe, 2004).

3. TË MËSUARIT NGA DISTANCA

Mësimi nga distanca i quajtur ndryshe edhe si edukimi në distancë apo mësimi online, është formë edukimi e cila përfshinë ndarjen fizike të profesorëve dhe studentëve gjatë mësimit dhe përdorimin e teknologjive të ndryshme për të lehtësuar komunikimin student-profesor dhe student-student. Mësimi në distancë tradicionalisht është fokusuar tek studentët jo tradicionalë, të tillë si punëtorët me orar të plotë, personeli ushtarak dhe jorezidentët ose individët në rajone të largëta të cilët nuk janë në gjendje të ndjekin ligjeratat në klasë. Fillimisht mësimi në distancë filloi me mësimet përmes postës. Në vitet 1840-ta, Issac Pitman u siguroi studentëve të tij kurse korrespondence. Në vitin 2017, 6.6 milion student u regjistruan për të ndjekur mësimin nga distanca. Mësimi në internet nga distanca është bërë një metodë edukimi, veçanarisht pasi të gjithë ne ishim të detyruarë të përshtatem me rrethanat e reja të paraqitura nga pandemia Covid-19, ku numri i studentëve që mësojnë nga distanca ka shkuar deri 400 milion student.

3.1. Mësimi Sinkron dhe Asinkron

Mësimi në distancë ndahet në dy kategori kryesore:

- Sinkron
- Asinkron

Mësimi sinkron i referohet një metode e cila e ofron mësimin që ndodhë në kohë reale. Kërkon komunikim të drejtpërdrejtë në internet, duke përdorur teknologji dhe platforma të ndryshme. Pra studentët duhet të takohen me profesorët dhe kolegët e tyre në orarin e paracaktuar më parë.

Mësimi asinkron nga distanca vjen me më shumë mundësi për ndërveprimin e studentave. Studentët mund të kenë qasje në përmbajtjen e kurseve përtej orës së mësimit, dhe mund të ndërveprojnë përmes bisedave në internet, kuizeve. Mësimi asinkron ju mundëson studentëve të mësojnë në kohën kur është e përshtatshme për ata. (Simon J. , 2021)

3.2. Llojet e edukimit në distancë

Ekzistojnë dy lloje kryesore të mësimit në distancë:

1. **Programet arsimore që ofrohen tërësisht në internet.** Në këtë lloj edukimi, kolegjet dhe universitetet i lejojnë studentët të ndjekin ligjeratat dhe të marrin udhëzime vetëm nga shtëpia, gjë e cila do të kërkojë një pajisje digjitale dhe një lidhje interneti.
2. **Programet e edukimit hibrid.** Në këtë lloj edukimi mësimi zhvillohet fizikisht dhe online. Studentët duhet të jenë prezent në objektin e Fakultetit disa herë, por ata gjithashtu duhet të jenë të pranishëm në mjedisin e mësimit online. (Papadopoulou, 2020)

3.3. Si funksionon mësimi në distancë

Kurset online zakonisht realizohen me përdorimin e një Sistemi të Menaxhimit të Mësimit ose LMS. Një LMS, mundëson krijimin e një grupi mësimesor, i cili lejon ndërveprimin student-profesor dhe me burimet mësimore. Me përdorimin e platformave mësimore, studentët online mund të dorëzojnë dhe pranojnë detyrat, të marrin ligjëratat, të marrin pjesë në kuize, biseda, pjesëmarrje të drejtpërdrejt në ligjëratat online, etj.

3.4. Cilat janë avantazhet e mësimit në distancë?

Në një mjedis online asinkron, i cili nënkupton se informacioni mund të mirret nga studentët atëherë kur ata kanë kohë. Pra kjo formë e mësimdhënies është një avantazh i madh për njerëzit që duan të marrin pjesë në distancë në programe që nuk do të mund t'i ndiqnin ndryshe. Mësimi në distancë është pa kosto dhe njëkohësisht na mundëson kursimin e kohës, dhe për këtë arsye i lejon pjesëmarrësit të kombinojnë punën, familjen dhe studimet.

Disa nga avantazhet e mësimit në distancë janë:

1. Vetë-frymëzimi

Studentët marrin përgjegjësi më të madhe personale. Ata duhet të qëndrojnë të mirëorganizuar dhe duhet të përformojnë mirë në një mjedis online.

2. Mundësia për të mësuar me ritmin tuaj

Nëse jeni të vetëdisiplinuar dhe të vetë-motivuar, përfitimi më i mirë i edukimit në distancë është se ju mund të mësoni me ritmin tuaj. Është një fakt i njohur që njerëzit mësojnë në mënyra të

ndryshme dhe me shpejtësi të ndryshme. Në një klasë, kur të gjithë mësojnë së bashku, shpesh është e vështirë të kesh çdo student në të njëjtën faqe. Pasi disa student janë shumë të turpshëm për të treguar se nuk janë duke kuptuar diçka. Ndërsa në mësimin nga distanca studenëve ju shpërndahet i tërë materiali dhe ata mund të studiojnë aq sa kanë nevojë çdo ditë, deri sa ta përfundojnë materialin për studim, nëse kanë pyetje mund të bisedojnë me profesorin ose studentët e tjerë përmes forumeve për diskutim. Kjo është një nga përparësitë e mësimin nga distanca në raport me mësimin tradicional.

3. Përshtatshmëria dhe liria

Profesorët mund të përshtatin mësimin në distancë për t'iu përshtatur nevojave të ndryshme arsimore të studentëve. Dhe u siguron studentëve lirinë për të mësuar kudo, me ritmin e tyre.

4. Qasje e lehtë

Pjesëmarrja në klasa është e pamundur për disa student, pasi përgjegjësitë e punës dhe jetës në shtëpi mund ta pengojnë. Mësimi në distancë siguron qasje të lehtë në arsim për të gjithë. Studentët kanë nevojë vetëm për një pajisje digjitale dhe një lidhje interneti.

5. Mundësi punimi dhe studimi në të njëjtën kohë

Për ata që punojnë me orar të plotë, mundësia për vazhdimin e studimeve të rregullta dikur ishte jashtë imagjinate. Ndërsa sot edhe pse je i punësuar mund të përmirësosh dhe avancosh aftësitë profesionale, pasi mësimi në distancë u mundëson studentëve që ata të mësojnë në mbrëmje apo në fundjavë.

6. Kursime në kosto dhe kohë

Mësimi në distancë kursen kohë dhe para. Studentët dhe profesorët nuk kanë pse të shqetësohen për kohën e udhëtimit dhe për shpenzimet për udhëtim. Kurset e mësimin në distancë shpesh i ofrojnë materialet mësimore në formë elektronike në internet. Pra edhe kjo ju ndihmon që studentët të ulin kostot e shpenzimeve për tekste mësimore.

3.5. Disavantazhet e mësimit në distancë

Edhe pse mësimi në distancë vjen me disa përparësi, nuk do të thotë se nuk ka anë negative. Më poshtë i kemi paraqitur disa disavantazhe të mësimit nga distanca:

1. Mundësia për shpërqendrim është e lartë

Pa asnjë profesor për ndërveprim ballë për ballë dhe pa koleg të klasës që mund të ndihmojnë me përkujtes të vazhdueshme për detyrat në rradhë, mundësia për t'u shpërqendruar dhe për të humbur afatet janë të mëdha. Ju duhet të mbani vetën të motivuar dhe të fokusuar nëse doni të përfundoni me sukses kursin tuaj të mësimit në distancë.

2. Kostot e fshehura

Edhe pse kostoja e një programi të edukimit në distancë është zakonisht më e lirë se një program i rregullt, kjo mund të ketë kosto të fshehura. Nëse ju jeni duke e ndjekur një kurs mësimi në distancë i cili ofrohet përmes internetit, mund të ju duhet të bëni disa shpenzime fillestare si sigurimi i një pajisje digjitale si dhe sigurimin e një lidhje të besueshme interneti. Gjithashtu mund të keni nevojë të bleni gjërat të tjera shtesë të tilla si printer, një kamerë, mikrofon, etj. Disa shpenzime i keni të përsëritura, si kostot për energji elektrike, për internet dhe mirëmbajtjen e pajisjeve digjitale.

3. Teknologjia e ndërlikuar

Varësia e tepërt nga teknologjia mund të jetë një pengesë e madhe në mënyrën e edukimit në mësimin në distancë. Nëse një softuer i një platforme nuk funksionon si duhet mund të ndërpres procesin e të mësuarit për një kohë të caktuar. Në mënyrë të ngjashme, nëse një student nuk është njohësi i kompjuterit dhe teknologjisë, përvoja e tij e të mësuarit nga distanca mund të jetë e pakënaqshme. (Bijeesh, n.d.)

4. GOOGLE CLASSROOM

4.1. Historiku i Google Classroom

Google Classroom u prezantua më 6 maj 2014, e cila ishte në disponim vetëm për disa antarë të programit G Suite të Google për Edukim (Magid, 2014). Është lëshuar publikisht më 12 gusht 2014 (Kahn, 2014).

Në vitin 2015, Google integroi Google Calendar në Classroom për përcaktimin e kohës së dorzimit të detyrave (Hockenson, 2015). Në vitin 2017, Google mundësoi që çdo përdorues i Googles të mund të bashkohet në Google Classroom pa pasur nevojë ta ketë një llogari në G Suite për Edukim. Dhe në Prill të të njëjtit vitë, u bë e mundur për çdo përdorues të Google-s që të krijoj dhe të mësoj në klasa të Google Classroom (Ressler, 2017).

Në vitin 2018, Google e prezantoi një ridizajnim të madh të Google Classroom-it. Kjo përfshinte shtimin e një seksionit të ri të punës në klasë, përmirësimin e ndërfaqës së notimit, lejon që një punë që është realizuar në një klasë të bartet edhe në klasat e tjera, si dhe ju lejon profesorëve që ta organizojn përmbajtjen sipas temës (Bukola, 2018).

Në vitin 2020, Google Classroom e integroi Google Meet në mënyrë që mësuesit ta kenë një lidhje unike brenda secilës klasë. Në vitin 2020, përdorimi i Google Classroom u rrit ndjeshëm, pasi shumë shkolla e përdorën këtë platformë për realizimin e mësimit nga distanca për shkak të pandemis COVID-19. (Yeskel, 2020).

4.2. Çfarë është Google Classroom

Google Classroom është një nga platformat më të njohura që iu mundëson profesorëve të krijojnë klasë virtuale për të komunikuar në mënyrë të lehtë dhe efikase me studentët e tyre. Përparësia e Google Classroom është që shfrytëzon edhe aplikacionet e tjera të Google si p.sh, Google Drive, në të cilën ruhen të gjitha materialet dhe mund të editohen me përdorimin e Google Docs apo Google Sheets. Gjithashtu përdorë edhe Google Slides, Sites Erth, Calendar dhe Gmail, mund të plotësohet gjithashtu edhe nga Google Hangouts ose Meet për mësim të drejtpërdrejt ose pyetje të drejtpërdrejta.

Për përdoruesit e Google, mirpo edhe për ata që deri më tani nuk kanë pasur rastin që të familjarizohen me të, Google Classroom mund të jetë përvoja ideale për të ngritur cilësinë e mësimdhënies dhe komunikimit profesor - student. (CPC, 2020)

Google Classroom u krijua si një mënyrë për të zvogëluar përdorimin e letrës në klasë, duke mundësuar dorëzimin e detyrave në mënyrë digjitale. Fillimisht ishte planifikuar për t'u përdorur me laptopë në institucione edukative, të tilla si Chromebook, në mënyrë që të lejojë profesorët dhe studentët të ndajnë në mënyrë më efikase informacionet dhe detyrat.

4.2.1. A është Google Classroom një LMS?

Teknikisht, jo. Google Classroom nuk është një sistem i pavarur i menaxhimit të të mësuarit (LMS), sistem i menaxhimit të kursit (CMS), ose sistem i informacionit të studentit (SIS). Që nga Prilli i vitit 2021, Google Classroom mund të sinkronizojë të dhënat me sistemet e informacionit të studentëve Skyward 2.0 dhe Infinite Campus. Sipas Google, më shumë janë duke u bërë integrimet e SIS në Google Classroom. Ndërsa Google Classroom është duke u përmirësuar, ajo mund të fillojë të duket dhe funksionojë, më shumë si një LMS (McGinnis, 2021).

4.3. Kush mund ta përdorë Google Classroom?

Çdokush! Google Classroom është një shërbim falas për këdo që ka një llogari personale të Google. Është gjithashtu falas për organizatat që përdorin Google Workspace për Edukim ose Google Workspace për organizatat jofitimprurëse. Në shumicën e rasteve, profesorët dhe studentët mund të hyjnë në Google Classroom duke përdorur një llogari të Google të siguruar nga shkolla e tyre, apo me llogari personale. Ndërsa është e ditur se profesorët dhe studentët janë përdoruesit kryesorë të Google Classroom, gjithashtu është e ditur se Google Classroom mund të përdoret edhe nga prindërit, administratorët dhe të tjerë. (McGinnis, 2021).

4.4. Në cilat pajisje punon Google Classroom?

Meqenëse Google Classroom është e bazuar në internet, ju mund ta përdorni atë në një farë forme nga pothuajse çdo pajisje me një shfletues uebi. Ekzistojnë aplikacione specifike të pajisjeve për Ios dhe Android, ndërsa funksionon gjithashtu në Mac, PC dhe Chromebook. Një avantazh i madh i Google është se në shumicën e pajisjeve është e mundur të bësh punë edhe kur nuk ki qasje në internet dhe ato do të ngarkohen sapo të kesh lidhje përsëri në internet. (Edwards, 2021)

4.5. Çfarë mundëson Google Classroom

Disa nga veprimet të cilat mund të i realizoni përmes Google Classroom janë:

- Ruajtja e materialeve të cilat postohen në Google Classroom, p.sh detyrat që ua caktoni studentëve tuaj apo shpërndarja e materialeve shtesë. Kjo ju lehtëson shumë punën dhe në të njëjtën kohë i mban të angazhuar studentët tuaj.
- Përmes Google Classroom ju i shmangëni format e komunikimit joformal për çfarëdo lloj njoftimi. Sapo të postoni ndonjë njoftim apo diçka tjetër studentët njoftohen edhe përmes email-it të tyre. Një përparësi është që ju mund të përzgjidhni student të caktuar të i pranojnë njoftimet e juaja, p.sh në rast se keni njoftime specifike për studentët e caktuar e jo për gjithë klasën.
- Një nga aktivitetet kryesore të juaja si profesor është padyshim caktimi, korigjimi dhe komentimi i detyrave për studentët. Google Classroom ju lejon që të krijoni detyra (“assignments”), kuize, detyra shtëpie apo materiale për diskutim dhe të caktoni kohën në dispozicion për përgjigje, pikët për vlerësim etj. Sapo të postoni detyrën, studentët pranojnë email-in dhe e kanë mundësin që drejtpërsëdrejti në Google Classroom të dorëzojnë detyra përmes opsionit “turn in”.
- Studentët kanë mundësinë po ashtu të jenë interaktiv përmes komentimit në postime, detyra apo të dërgojnë email-a njëri-tjetrit.

4.6. A mund ta përdorin profesorët Google Classroom për vlerësime dhe notime?

Po, Google Classroom mund t'i ndihmojë profesorët të përmirësojnë vlersimet formative dhe sumative (përmbledhëse). Për shembull, ju mund të përdorni platformën Google Classroom për të krijuar, shpërndarë dhe mbledhur shpejt informacione digjitale ose vlerësime të vlerësuara automatikisht. Profesorët gjithashtu mund të paraqesin pyetje diskutimi për të parë se çfarë mendojnë studentët për ndonjë gjë të caktuar.

Duke përdorur të njëjtat mjete, profesorët gjithashtu mund të krijojnë vlerësime sumative (përmbledhëse), si test njësie apo test për një temë mësimore etj. Këto teste mund të përfshijnë lloje tradicionale të pyetjeve si përgjigje e shkurtër ose paragraf, pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, e të tjera. Ka gjithashtu mundësi që studentët të ngarkojnë skedarë (si filma, foto, dokumente) kur i përgjigjen një pyetjeje. Duke i lejuar studentët të ndajnë njohuritë e tyre në mënyra të ndryshme.

Përditësimet e fundit në Google Classroom kanë përfshirë karakteristikat për rubrikat dhe notat. Profesorët thjesht mund të japin lloje të ndryshme të detyrave (ese, punë në klasë, detyrë shtëpie, etj.), dhe i caktojnë pikët për detyrat e ndryshme varësisht nga rëndësia e tyre. Ju mund të krijoni rubrika në Google Classroom dhe studentët mund t'i shikojnë këto ndërsa funksionojnë. Puna e studentëve vlerësohet me notë në rubrika dhe rezultati do të llogaritet automatikisht.

4.7. Si mund ta mbështesë Google Classroom mësimdhënien e diferencuar?

Google Classroom e bënë të lehtë personalizimin e detyrave për student individual ose grupe të vogla. Profesorët mund të japin detyra të modifikuara ose të ndryshme për studentë ose grupe specifike në një klasë. Ju gjithashtu keni mundësinë të regjistroheni me një student privatisht për të parë nëse ata kanë pyetje ose kanë nevojë për ndihmë shtesë. Një strategji e diferencimit në internet si kjo mund t'i bëjë përpjekjet tuaja më pak të dukshme në klasë, kështu që studentët nuk do të ndihen të veçuar. (McGinnis, 2021)

4.8. Avantazhet e Google Classroom në edukim

Disa nga avantazhet e përdorimit të platformës Google Classroom në edukim janë:

1. E lehtë për tu përdorur dhe mund të qaseni nga çdo pajisje.

Edhe nëse nuk jeni përdorues i Google, përdorimi i Google Classroom është mjaft i lehtë. Përveç që mund të qasni duke përdorur shfletuesin Chrome, e cila e bënë të arritshme Google Classroom nga të gjithë kompjuterët, celularët dhe tabletët, është vërtet e lehtë që të krijoni klasë, të shtoni student, të krijoni dokumente të Google-s për të menaxhuar detyrat dhe njoftimet, postoni video nga YouTube, të bashkëngjitni skedarë nga Google Drive. Gjithashtu edhe studentët e kanë po aq të lehtë të identifikohen, si dhe të marrin dhe të dorëzojnë detyra.

2. Komunikimi dhe ndarja e të dhënave në mënyrë efektive

Një nga avantazhet më të mëdha të Google Classroom janë Google Docs. Këto dokumente ruhen në internet dhe ndahen me një numër të pakufizuar njerëzish, kështu që kur krijoni një njoftim ose detyrë duke përdorur një dokument të Google, studentët tuaj mund ta shfletojnë atë menjëherë përmes Google Drive, për sa kohë që dokumentet janë të ndara me ta. Ju nuk keni më nevojë për postë elektronike për ta ndarë informacionin, ju thjesht krijoni një dokument dhe e ndani atë me studentët që ju dëshironi.

3. Shpejton procesin e dorëzimit të detyrës

Procesi i dorëzimit të detyrave nuk ka qenë kurrë më i shpejtë dhe më efektiv, pasi në Google Classroom mund të kontrolloni lehtësisht se kush e ka dorëzuar detyrën e tyre dhe kush po punon akoma, si dhe mund të jepni menjëherë reagimet tuaja.

4. Reagime efektive

Duke folur për reagimet, Google Classroom ju jep mundësinë të ofroni mbështetjen tuaj online për studentët tuaj menjëherë, kjo do të thotë që reagimet bëhen më efektive, pasi komentet dhe vërejtjet kanë ndikim më të madh tek studentët.

5. Nuk ka nevojë për përdorimin e letrës

Duke i përdorur dokumentet elektronike (detyrat e studentëve) në një platform të bazuar në re, ju i ndihmoni studentët tuaj në mënyrë që ata të mos shqetësohen për shtypjen e dokumenteve, shpërndarjen ose edhe humbjen e detyrave të tyre. Në të njëjtën kohë bëhet edhe kursimi i letres, që është shumë efektive.

6. Sistem i shkëlqyeshëm i komunikimit

Google Classroom mundëson që brenda klasave të realizohet diskutimi në mes studentëve dhe profesorëve në mënyrë efektive.

7. Është për të gjithë

Google Classroom mund të përdoret nga të gjithë që janë të interesuar.

4.9. Disavantazhet e Google Classroom në edukim

Asgjë nuk është përfekte edhe platforma Google Classroom ka akoma vend për përmirësim, deri sa ti plotësoj të gjitha nevojat dhe kërkesat e profesorëve dhe studentëve.

Disa nga disavantazhet e përdorimit të platformës Google Classroom në edukim janë:

1. Çdo përdorues ka nevoj për llogarinë e vet Google

Google Classroom nuk lejon hyrjen në klasa nga disa llogari të Gmail-it. Për shembull, nëse keni një dokument të Google ose një pikturë në Gmail-in tuaj dhe dëshironi ta ndani atë në Google Classroom të cilën e keni të hapur me Gmail të institucionit (p.sh të universitetit), do të ju duhet ta ruani veçmas në hard diskun e kompjuterit tuaj, të dilni nga llogaria juaj personale të kyqeni në llogarin e universitetit e pastaj mund të ndani ato të dhëna me klasën tuaj.

2. Nuk mund të realizosh një video

Ju mund të përdorni Google Hangouts për të bërë video të drejtpërdrejta dhe YouTube për të vendosur video në Google Classroom. Sidoqoftë, Google Classroom akoma nuk e ka të zhvilluar mundësin për të realizuar video konferenca. Por profesorët mund të përdorin mjete të tjera të Google-së për realizimin e videove.

3. Nuk lejon komunikimin me persona që nuk janë të kyqur në klasë

Nëse keni nevojë të kontaktoni me kujdestarin e një klase, për t'i bërë një pyetje, Paneli i Google Classroom nuk është në gjendje që të ju mundësoj këtë kontaktim. Sidoqoftë, ju mund të krijoni një klasë ku mund ti bashkëngjitni të gjithë kujdestarët dhe ti raportoni për klasët e tyre, ose ti njoftoni të gjithë një nga një por kjo merr mjaftueshëm kohë. (Knerl, 2021)

3.10. Krijimi i llogarisë në Google Classroom


Ngjashëm me aplikacionet e tjera të Google, për të përdorur Google Classroom ju duhet të keni llogari të Google. Sigurisht, Google Classroom funksionon në mënyrë më efektive, nëse keni email të institucionit arsimor me domenin përkatës (p.sh. uni-pr.edu). Në këtë rast, edhe studentët e juaj duhet të kenë domenin e njejtë me juve në mënyrë që të mund të anëtarësohen (pra, p.sh.: studenti@uni-pr.edu). Mirëpo kjo nuk i kufizon profesorët apo studentët të cilët nuk janë të pajisur me email zyrtarë të institucionit ku vijnë studimet. Ju si profesor mund të përdorni Google Classroom përmes email-it tuaj personal (p.sh.: filan.fisteku@gmail.com), dhe studentët mund të qasen, kyçen duke përdorur po ashtu email-in e tyre personal (p.sh.: sofijeshkodra@gmail.com).

Shkruani adresën classroom.google.com në “browserin” tuaj (p.sh. Chrome, Safari, Internet Explorer, Firefox, Microsoft Edge);



classroom.google.com

Në çoftëse ju nuk keni një llogari në Google atëhere duhet ta krijoni një llogari duke klikuar në linkun “Create Account”. Futni të dhënat e kërkuara dhe kujdesuni që e keni memorizuar dhe/apo ruajtur emrin e përdoruesit (“username”) dhe fjalëkalimin (“password”). Keni parasysh që fjalëkalimi duhet të ketë të paktën 8 karaktere dhe duhet të përmbajë shkronja, numra dhe simbole (p.sh.: Test15!@5)



Google

Create your Google Account

First name Last name

Username

You can use letters, numbers & periods

[Use my current email address instead](#)

Password Confirm

Use 8 or more characters with a mix of letters, numbers & symbols

Show password

[Sign in instead](#)

One account. All of Google working for you.

Figura 1. Krijimi i Llogaris në Google

Pas plotësimit të të dhënave, vazhdoni duke klikuar butonin “Next”. Pas kalimit të hapit të parë do të ju kërkohet të futni numrin tuaj të telefonit për të verifikuar llogarinë meqë rast ju vie një SMS në telefon me kodin të cilin duhet ta shtoni në pjesën përkatëse. Në faqën e ardhshme, do të ju kërkohet që të shtoni edhe datën tuaj të lindjes dhe gjininë. Së fundi duhet të pranoni kushtet e Google përmes klikimit “Agree” në fund të faqës.

Duke vepruar sipas hapave të lartcekur ju tashmë keni krijuar llogarinë tuaj në Google Classroom.

Faqja e radhës duket kështu:




Figura 2. Krijimi i llogarisë në Google Classroom

Për të vazhduar, klikoni në butonin “Continue”.

3.10.1. Si të krijoni një klasë virtuale në Google Classroom si profesor

Pas kyçje në Google Classroom, do të ju paraqitet figura e mëposhtme, ku ju kërkohet të zgjidhni rolin tuaj. Nëse jeni profesor, zgjidhni rolin “I’m a teacher” ndërsa nëse jeni student zgjidhni rolin “I am student” duke klikuar mbi figurën gjegjëse.



Pas përzgjedhjes së rolit tuaj, pasi të keni klikuar tek simboli “+” në pjesën e sipërme në anën e djathtë, do ju paraqiten dy opsione: “Joni class” dhe “Create class”. Përderisa opsioni i parë është

i vlefshëm për student, opsioni i dytë **“Create class”** ju ofron mundësinë që si profesor të krijoni një klasë në Google Classroom.




Figura 3. Mundësia për krijim të klasës apo bashkim në klasë

Pastaj nëse dëshirojm të krijojm një klasë duhet ta shtypim butonin **“Create class”**, pastaj futni të dhënat e klasës. Me rëndësi është emri i klasës **“Class name”**, p.sh. Teknologji me Tik – Klasa e tetë. Pas plotësimit, kliko butonin **“Create”** në fund.

Create class

| |
|-----------------------|
| Class name (required) |
| Section |
| Subject |
| Room |

Cancel Create

Figura 4. Plotësimi i të dhënave për krijimin e një klase

Pas plotësimit të të dhënave faqja do të ju duket kështu




Figura 5. Krijimi i klasës “Teknologji me Tik – Klasa e tetë”

Pas krijimit të klasës duhet ta studioni pak aplikacionin, duke shfletuar tek secila pjesë e meny-së.

Çfarë funksione mund të realizoni më tutje?

Siç mund të shihni në shikim të parë, klasa e juaj virtuale përbëhet nga 4 menyë kryesore të cilat janë:

1. Stream
2. Classwork
3. People
4. Grades

Le të shohim se për çfarë shërbejnë secila prej tyre.

4.10.1.1. Menyja “Stream”

Në pjesën e parë (“Stream”), ju mund të komunikoni me klasën tuaj (“Communicate with your class here”), duke krijuar detyra apo duke postuar njoftime (“Create and Schedule announcements”) si dhe duke u përgjigjur në postimet e studentëve (“Respond to student posts”). Për të filluar me postimin tuaj të parë klikoni mbi **“Share something with your class”**. Në momentin që klikoni do të shihni se faqja ndryshon pamjen si në figurën më poshtë:




Figura 6. Mënyra si të postoni në klasë për studentët tuaj

Përveç tekstit, njoftimit tuaj mund ti shtoni edhe një **“attachment”** apo **“file”** si p.sh. dokument, link, video nga YouTube apo material nga Google Drive duke klikur mbi butonin **“Add”**.

Tek pjesa ku shihet **“All students”** ju mund të zgjidhni që postimin ta shohin të gjithë studentët, apo student të caktuar të cilët mund ti zgjedhni nga lista që ju shfaqet. Në fund klikoni mbi butonin **“Post”** që të publikoni materialin, i cili aktivizohet sapo të shkruani diçka në fushën përkatëse.

Në pjesën e sipërme majtas, gjindet kodi i klasës (“Class code”) i cili është i ndryshëm për çdo klasë dhe gjenerohet automatikisht. Këtë kod mund ta shpërndani tek studentët në mënyrë që ata të identifikojnë, gjejnë, dhe bëhen pjesë e klasës virtuale.





Figura 7. Kodi për bashkangjitjen e nxënësve/studentëve në klasë

Përveç kësaj, ju mund të ndryshoni edhe pamjen e klasës (ngjyrën, fotografinë) duke klikuar tek **“Select theme”** ose **“Upload photo”**.



Pas klikimit tek opsioni **“Select theme”** dhe pasi kemi zgjedhur një pikturë të gatshme e shohim se si e kemi ndryshuar pamjen e klasës.



Figura 8. Ndryshimi i pamjës së klasës

4.10.1.2. Menyja “Classwork”

Nëse klikoni tek menyja “Classwork”, rezultati do të jetë si mëposhtë:




Figura 9. Menyja Classwork

Siç mund të shihni, kjo faqe është e destinuar për të caktuar detyra për klasën tuaj (“Assign work to your class here”). Kjo përfshinë përveq tjerash, krijimin e detyrave dhe pyetjeve, organizimin e materialeve dhe temave në njësi mësimore apo module.

Për të filluar punën operacionale, filloni duke klikuar në butonin “Create” meqë rast do të ju paraqiten këto opsione:




Figura 10. Butoni “Create”

- Assignment (“Detyrë”)
- Quiz Assignment (“Kuiz”)
- Questions (“Pyetje”)
- Material (“Material”)
- Topic (“Tema apo njësi mësimore”)
- Reuse post (“Po ashtu, nëse keni ndonjë klasë tjetër ju mund të ripërdorni detyrat nga klasë tjera përmes opsionit Reuse post”).

Le të shikojm një shembull të krijimit të një detyre:

Pasi keni klikuar mbi butonin “**Create-Assignment**”, do të ju shfaqet dritarja si më poshtë:




Figura 11. Faqja për krijimin e një detyre

Për të caktuar titullin e detyrës klikoni nën “**Title**” ndërsa në fushën në pjesën e poshtme mund të jepni udhëzime për përfundimin e detyrës, mirëpo kjo është opsionale “Instructions (optional)”.

Ngjashëm me postimet, edhe këtu mund të shtoni dokumente (“files”), vegëza, video apo të krijoni Google Docs, Google Sheets, Google forms, këto veprime mund ti realizoni duke klikuar mbi “**+Create**”.

Në anën e djathtë tek pjesa **“For”** mund të zgjedhni nëse detyra vlen për të gjithë studentët apo vetëm për student të caktuar **“All students”** apo vetëm për ata/ato që i keni përzgjedhur. Nëse dëshironi që detyra të vlerësohet me pikë, ju mund të përdorni opsionin **“Points”** dhe në mënyrë manuale të vendosni se me sa pikë do e vlerësoni detyrën. Nëse nuk dëshironi që detyra të vlerësohet me pikë zgjedh opsionin **“Ungraded”** i cili ju shfaqet pasi keni klikuar tek **“Points”**.

Pas kësaj ju mund të caktoni kohën e fundit se kur studentët mund të dorëzojnë detyrat duke klikuar tek pjesa **“Due”** dhe duke caktuar datën dhe orën. Ju gjithashtu mund të përzgjedhni nëse doni ta fusni detyrën si pjesë e një teme të caktuar **“Topic”**.

Në fund klikoni tek pjesa **“Assign”** meqë rast studentët do të njoftohen përmes email-it për detyrën e re.

Pasë plotësimit të të gjitha udhëzimeve të lartë cekura detyra do të duket si në figurën e redhës:





Figura 12. Krijimi i detyrës për studentë

Në pamje të parë mund të shini se sa nga studentët e kanë dorëzuar detyrën **“Turned in”** dhe sa prej tyre ende nuk e kanë bërë këtë nga totali i studentëve **“Assigned”**. Për të parë detyrën e dorëzuar klikoni mbi **“View assignment”**.

Të gjitha materialet të cilat ndahen me studentët ruhen automatikisht në Google Drives të klasës siç mund të shihet në anën e djathtë në figurën e radhës. Përveç Google Drive, ju mund edhe të krijoni ngjarje/takime në Google Kalendar (“Google Calendar”) i cili shërben vetëm për klasën tuaj.



Nëse klikoni në butonin “**Class Drive folder**”, do të ridrejtoheni tek Google Drive ku mund edhe të shtoni materiale direkt tek sektori “**Drop files here**”.




Figura 13. Class Drive polder

4.10.1.3. Menyja “People”

Për të shtuar studentët, mirëpo edhe për t’i parë studentët si listë kur ata të jenë bërë pjesë e klasës, klikoni tek menyja “**People**” në pjesën e sipërme. Faqja do të duket si në figurën e më poshtme:






Figura 14. Menyja People

Keni parasysh që përveq studentëve, ju mund të shtoni edhe profesor të tjerë, tek pjesa “**Teachers**” duke klikuar në butonin .

Për të shtuar studentët sigurohuni që të gjithë kanë llogari të Google, pasi email-at e tjerë nuk pranohen. Për të ftuar studentët ekzistojnë dy mënyra:

1. Ftoni studentët përmes kodit të klasës (“class code”), i cili gjenerohet automatikisht. Në shembullin tonë, kodi i klasës është “**2mc3jzs**”. Ndërsa mesazhi “Invite students or give them the class code 2mc3jzs” do të thotë “Ftoni nxënësit tuaj ose jepni atyre kodin e klasës”.

- Mundësia e dytë është përmes shtimit të tyre duke klikuar në butonin përkatës tek seksioni  ”**Students**” dhe duke shtuar manualisht email-at e studentëve që dëshironi ti bëni pjesë të klasës virtuale.

Për shkak të fleksibilitetit, rekomandohet opsioni i parë, pra ftimi i studentëve përmes kodit të klasës.

4.10.1.4. Menyja “**Grades**”

Së fundmi menyja “**Grades**” ju mundëson që të shihni në një vend të gjitha detyrat e dorëzuara të studentëve dhe t’i vlerësoni ato me pikët apo notat përkatëse. Pra kjo meny është e lidhur ngusht me menyn “**Classwork**” dhe pas krijimit të një detyre për studentët, ajo automatikisht do të figuroj tek menyja “**Grades**”.




Figura 15. Menyja “Grades”

4.10.2. Antarësimi në një klasë virtuale dhe përdorimi i Google Classroom për studentët

Pasi jeni qasur, kyçur, me llogarin tuaj në www.classroom.google.com sigurohuni se e keni zgjedhur rolin tuaj si student.



Klikoni tek “+” në pjesën e sipërme në anën e djathtë, për ti’u bashkuarë një klase në Google Classroom. Shtoni kodin të cilin e keni marrë nga profesori juaj dhe klikoni “Join”.

Class code
Ask your teacher for the class code, then enter it here.

Përveq anëtarësimin përmes kodit nga profesori juaj, ju mund të anëtarësoheni edhe përmes pranimit të ftesës nga profesori përmes email-it tuaj. Emaili në titullin (“Subject”) shkruan Class Invitation:”Emri i klasës”. Klikoni “**JOIN**” për të pranuar ftesën.




Figura 16. Pamja e klasë nga studentët

Pasi të jeni bërë pjesë e klasës, si studentë do të keni pothuajse të njëjtën pamje sikur profesori i klasës. Sidoqoftë, siç mund të vëreni tek menyja në pjesën e sipërme ju shfaqen tri meny në vend të katër (“Stream”, “Classwork”, “People”). Pra, mos shfaqja e menysë së notave (“Grades”) është plotësisht logjike duke marr parasysh se vetëm profesori bënë vlerësimin e punës së studentëve.

Menyja “**Stream**” dhe “**People**” është identike në dukje me sqarimet më lartë dhe sqarimet e njëjta vlejné edhe për studentët. Le të shohim menynë “**Classwork**”, ku ju duhet si student të dorëzoni detyrat e përcaktuara nga profesori juaj.

Në rastin tonë, pas klikimit të detyrës si në shembullin më lartë, studenti do ta ketë këtë pamje:




Figura 17. Pamja e detyrës tek studentët

Pasi të keni klikuar mbi “View assignment” – do ta keni këtë pamje:




Figura 18. Pamja “View assignment”

Nëse keni ndonjë pyetje, paqartësi apo çfarëdo komenti për detyrën, ju mund të komentoni tek postimi apo në anën e djathtë nëse preferoni që komenti juaj të jetë privat “**Private comments**”, të mos shihet nga studentët e tjerë.

Për të dorëzuar detyrën tuaj klikoni mbi “**+Add or create**” meqë rast ju mund të shkarkoni dokumentin nga pajisja (kompjuteri, tableti, apo telefoni) juaj apo të krijoni dokument të ri qoftë Google Docs, Slides, Forms etj. Në fund klikoni “**Mark as done**” dhe automatikisht profesori do të njoftohet se ju e keni dorëzuar detyrën. (CPC, 2020)

5. GOOGLE MEET

5.1. Historiku i Google Meet

Google Meet (i njohur më parë si Hangouts Meet) është një shërbim video-komunikimi i zhvilluar nga Google. Google Meet dhe Google Chat pretendojnë ta zëvendësojnë Google Hangouts. (Johnston, 2017)

Në shkurt të 2017, Google lëshoi në heshtje aplikacionin për përdorim në Ios. Zyrtarisht Google Meet u lansua në Mars të vitit 2017. Fillimisht Google Meet mundësonte lidhjen e 30 personave në një takim. Në Google Meet mund të qaseni përmes uebit, aplikacioneve Ios dhe Android (Perez, 2017) (Johnston, 2017).

5.2. Çka është Google Meet

Google Meet, i quajtur më parë Google Hangouts Meet, është program i cili mundëson video konferenca, është pjesë e Google Workspace (më parë G Suite). Google Meet ofron funksione që nuk shihen në Hangouts, si titra në kohë reale dhe mbështetje për deri në 250 pjesëmarrës dhe 100,000 shikues në transmetim të drejtpërdrejtë. Përdoruesit e Google mund të qasen në Google Meet duke shënuar në shfletues www.meet.google.com, ose takimet mund të rezervohen paraprakisht duke përdorur Google Chat ose Google Calendar.

5.3. Avantazhet e Google Meet

Disa nga avantazhet e përdorimit të Google Meet në edukim janë:

1. Është falas për përdoruesit e Google

Google Meet është falas për të gjithë përdoruesit e Google-s. Versioni falas mbështet deri në 100 pjesëmarrës. Afati kohor për përdoruesit falas është 60 minuta.

2. Integrimi me shërbimet e tjera Google

Google Meet mundëson ndarjen e skedarëve dhe imazheve në kohë reale. Gjithashtu integrohet me Google Contacts dhe Google Calendar, për thirrje me një klikim ose pjesëmarrje në takime. Nëse përdoret një version i Google Meet i paguar përmes Google Workspace atëherë mundëson titra në kohë reale të asaj që follet në takim. Përdoruesit që e përdorin versionin e paguar të Google Meet gjithashtu kanë qasje në hapsirën ruajtëse në cloud përmes Google Drive, në aplikacionet për

ndarjen e shënimeve, Google Docs, Google Form si dhe mbështetjen e klientit gjatë gjithë kohës përmes bisedës, email-it, dhe telefonit.

3. I lehtë për tu përdorur

Një avantazh tjetër i Google Meet është se është relativisht i lehtë për tu përdorur. Antarsimi në një takim është aq i thjeshtë sa klikimi ose prekja e një butoni. Gjithashtu edhe krijimi i një takimi është po aq i thjeshtë, ku fillimisht duhet ta hapim platformën, e krijojmë lidhjen dhe e dërgojmë lidhjen e takimit tek pjesëmarrësit përmes aplikacioneve të mesazheve, email-it ose duke krijuar një ngjarje në Google Calendar. Google Meet ka një pamje shumë të pastër dhe të thjeshtë për përdorim.

4. Cilësi të audios dhe videos, siguri në performancën e përgjithshme

Rezolucioni për burimet e videove hyrëse dhe dalëse është 360p. Gjithashtu rezolucioni mund të rregullohet deri në 720p. Është interesante të theksohet se përdoruesit mund të ndryshojnë individualisht rezolucionin për burimet e dërgimit dhe marrjes, duke iu mundësuar atyre kontroll më të mirë në dërgimin-pranimin e të dhënave. Cilësia dhe performanca e përgjithshme varet nga faktorët që përfshijnë shpejtësinë e internetit dhe aftësisë harduerike të pajisjes ku është hapur platforma.

Siguria është e garantuar përmes infrastrukturës globale të IT-së së Google. (Simon, 2021)

5.4. Disavantazhet e Google Meet

Disa nga disavantazhet e përdorimit të Google Meet në edukim janë:

1. Google Meet nuk lejon ndarjen e ekranit nga dy persona në të njëjtën kohë. Vetëm një pjesëmarrës mund ta ndajë ekranin në të njëjtën kohë.
2. Është e vështirë të dërgosh materiale multimediale përmes aplikacionit.

5.5. Krijimi i një llogarie në Google Meet

5.5.1. Krijimi i një takimi nga shfletuesi

Për të krijuar një llogari në Google Meet, së pari duhet në ndonjë shfletues ta shkruani meet.google.com, pastaj do të ju shfaqet pamja si më poshtë.




Figura 19. Pamja fillestare e Google Meet në Ueb


Për të përdorur aplikacionin e Google Meet ju duhet ta keni një llogari të hapur të Google, nëse nuk keni llogarit të hapur atëherë duhet të klikoni tek butoni “**Sing up for free**” dhe ta hapni një llogari të Google sipas udhëzimeve që i kemi dhënë tek përdorimi i Google Classroom.

Pasi ta keni krijuar llogarin në Google, mund të filloni menjëherë një takim ose të futni kodin e një takimi ekzistues për t’u bashkuar me një telefonatë ose konferencë. Dhe do të shfaqet pamja si në figurën e më poshtëme.


Premium video meetings. Now free for everyone.

We re-engineered the service we built for secure business meetings, Google Meet, to make it free and available for all.

 **New meeting**

 Enter a code or link

[Learn more](#) about Google Meet



Get a link you can share

Click **New meeting** to get a link you can send to people you want to meet with

Figura 20. Pamja pas logimit me llogari të Google-së në Google Meet

Një mënyrë tjetër për hapjen e Google Meet nëse ju e keni një llogari të Google është, së pari duhet ta hapni shfletuesin e pastaj nga ana e djathtë e shfletuesit gjindet një buton me disa pika ku gjinden Aplikacionet e Gogles pasi të klikoni hapet një dritare e vogël ku ju mund të klikoni tek Google Meet.





Figura 21. Qasja në Google Meet direkt nga Shfletuesi

Pastaj do të ju hapet dritarja e Google Meet nga ku mund të bashkoheni në ndonjë klasë apo të krijoni një klasë të re njejtë sikurse pamja e më parshme.



5.5.2. Krijimi i një takimi përmes email-it

Një mënyrë tjetër për të krijuar një takim të ri apo të bashkangjiteni në një takim është përmes llogarisë tuaj nga email-i. Do të vini re se në anën e majtë, tek dosja elektronike, ekziston një pjesë nga ku ju mund të qaseni në Google Meet. Ku ekzistojnë dy mundësi për tu bashkangjitur në takim apo për të krijuar një takim sikurse në figurën e më poshtme.




Figura 22. Mënyra për krijimin e një llogarit e Google Meet nga email-i

Pasi të klikojm tek butoni “**New meeting**” do të na hapet një dritare dialoguese e cila na pyet nëse dëshirojm ta krijojm një takim të ri apo një takim ekzistues.




Figura 23. Krijimi i një takimi përmes email-it

Nëse klikojm në butonin “**Joni a meeting**” do të na hapet dritarja dialoguese si më poshtë, ku duhet ta shënojm kodin e takimit. (Stanton, 2021)




Figura 24. Bashkimi në takim përmes email-it

5.5.3. Caktimi i një takimi përmes Google Calendar

Një nga karakteristikat më interesante të Google Meet është se ju mund të planifikoni takime. Kjo ju mundëson që ju më heret ti njoftoni pjesëmarrësit në mënyrë që të qasen të gjithë në takim. Fillimisht hapni shfletuesin e Google pastja zgjidhni opsionin Google Calendar si në figurën e më poshtme.




Figura 25. Qasja në Google Calendar

Pastaj pasi ta klikojm tek botoni “Calendar”, do të na shfaqet dritarja si në figurën e më poshtme.






Figura 26. Hapja e faqes Google Calendar

Për të krijuar një ngjarje duhet të klikojmë tek butoni “**Create**” pastaj do të na shfaqet dritarja si në figurën e më poshtme.



Ku kemi mundësinë për shtimin e pjesëmarrësve përmes email adresës, pasi të kemi shtuar pjesëmarrësit, ta kemi rregulluar orën dhe datën e takimit shtypim butonin “**Save**”. Pasi ta shtypni butonin **Save** do të ju hapet një dritare dialoguese e cila ju pyet nëse dëshironi që të ftuarit tuaj ta marrin një email për tu njoftuar se kur do të mbahet takimi përmes email-it. (Stanton, 2021)



5.5.4. Si ta përdorni Google Meet nga telefoni

Ndërsa aplikacioni Gmail është aplikacion në shumicën e telefonave inteligjent, aplikacioni Google Meet nuk është. Pra, ju duhet ta shkarkoni aplikacionin nga Play Store ose App Store, në varësi të sistemit tuaj operativ. (Stanton, 2021)




Figura 27. Instalimi i Google Meet në telefon

Pasi ta instaloni aplikacionin, ju mund të bashkangjiteni në një takim apo të krijoni një takim të ri.




Figura 28. Hapja e aplikacionit Google Meet në telefon

5.5.5. Krijimi i një takimi në Google Meet nëpërmjet Google Classroom

Për të krijuar një takim në Google Meet nuk duhet domosdoshmërisht përmes <https://meet.google.com>, por mund të qasemi edhe nga Google Classroom. Për të krijuar një takim nga Google Classroom fillimisht ju duhet ta keni të hapur llogarinë në G-suite for education, pastaj duhet ta përzgjedhni klasën ku doni të mbani ligjëratë. Pastaj duhet të shtypni butonin “Settings”.




Figura 29. Class Settings

Pasi të shtypni butonin “Settings” ju hapet një dritare, pastaj shkoni tek pjesa “General”, klikoni tek “Enable Meet Link”, pastaj do të ju aktivizohet një link i takimit si në figurën e më poshtme.




Figura 30. Enable Meet Link

Nëse dëshironi ta ndani këtë link me studentët tuaj, ju mund:

- Ta kopijoni linkun nga shigjeta zbritëse dhe ta ndani atë me studentët tuaj me çdo mjet komunikimi p.sh., email, mesazhe, njoftimi përmes klasës, etj.




Figura 31. Kopijimi i linkut të Google Meet

- Gjithashtu ju mund të vendosni që linku i takimit të paraqitet në faqën kryesore të takimit përmes aktivizimit të butonit, dhe pastaj të klikoni butonin “Save” në këndin e sipërm të djathtë të ekranit si në figurën e më poshtme.




Figura 32. Paraqitja e linkut të Google Meet e dukshme për studentët

Faqja kryesore e kursit tani do të ketë një link për takim në titullin e kursit ku do të kenë qasje të gjithë pjesëmarrësit.



Figura 33. Paraqitja e linkut në faqen kryesore të kursit

5.6. Video Konferenca / Klasa e drejtpërdrejtë duke përdorur Google Meet

Nëse dëshironi të realizoni ligjerat të drejtpërdrejta me student, ju fillimisht duhet ti njoftoni studentët tuaj për kohën kur do ta mbani ligjeratën, pastaj ju duhet të klikoni mbi linkun e takimit të cilën e keni shpërndarë më përpara me studentët tuaj. Sapo të klikoni mbi link do të aktivizohet lidhja juaj, dhe duhet të pritni deri sa të kyçen studentët në takim.




Figura 34. Pamja e takimit në Google Meet pasi mësimdhënësi klikon në link

Pasi studentët të klikojnë në linkun e takimit do të ju hapet dritarja si në figurën e më poshtme. Duhet të klikoni mbi butonin “**Join now**”, dhe do të qaseni në ligjeratën e drejtpërdrejtë.




Figura 35. Pamja e takimit në Google Meet pasi studenti klikon në link

Udhëheqsi i takimit e ka mundësinë pasi ta hap takimin ta shpërndaj linkun e takimit apo të shtoj personat e dëshiruar në takim si në figurën e më poshtme.




Figura 36. Informacioni për ftimin e studentëve në takim

Klikoni në “**Add people**” për të shtuar pjesëmarrës në takim, ju mund të shtoni pjesëmarrës në takim edhe nëse ata nuk i takojn klasës suaj.




Figura 37. Shtimi i pjesëmarrësve në takim

Shënoni emrin e njerëzve që dëshironi t’i ftoni, ose mund të klikoni në “**invite**” për t’i shtuar, ose mund t’i dërgoni një ftesë përmes email-it.




Figura 38. Ftesa për pjesëmarrje në takim

Klikoni në ikonën e njeriut, e cila tregon numrin e njerëzve aktiv në takim.




Figura 39. Shikimi i numrit të personave në takim

Lista e personave aktivë në takim do të shfaqet si në figurën e më poshtme.




Figura 40. Lista e personave aktiv në takim

Për të biseduar me anë të mesazheve klikoni në ikonë “**Chat icon**” dhe do të ju aktivizohet dritarja për komunikim.





Figura 41. Mundësi për të shkëmbyer mesazhe në Google Meet

5.6.1. Google Meet Settings

Ekzistojnë një numër opsionesh për ta menaxhuar takimin e drejtpërdrejtë. Fillimisht duhet të klikoni në ikonën e “**Settings**” për të parë se çka mund të bëjmë përmes kësaj dritare.



5.6.1.1. Whiteboard (Dërrasa e bardhë)

Sapo të klikoni tek opsioni “**Whiteboard**” do të ju shfaqet një dritare e cila ju pyet nëse dëshironi të krijoni një tabel të re apo nëse dëshironi ta hapni një ekzistuese.




Figura 42. Dërrasa e bardhë

Sapo të klikojm tek opsioni “**Start a new whiteboard**” do të na hapet një dritare nga e cila profesori mund të vizatoj, të shkruajn etj. Për t’i bërë gjërat më të kjartha për studentët e tyre.




Figura 43. Hapja e dërrasës së bardhë

Nëse klikojm tek opsioni “**Chose from drive**” do të na shfaqet dritarja në të cilën ruhen të gjitha tabelat në të cilat ne kemi punuar të cilat pastaj mund t’i hapni përsëris.




Figura 44. Zgjedhja e tabelave të ruajtura

5.6.1.2. Change Layout (Ndrysho layout-in)

Klikoni tek opsioni “**Change Layout**” nga menyja e settings për të ndryshuar paraqitjen e pamjes së takimit.




Figura 45. Opsioni Change layout

Pasi të klikoni tek butoni “**Change layout**” do të ju hapet një dritare nga e cila mund të caktoni se çfarë pamje do të ketë takimi juaj.




Figura 46. Opsionet e layout-it

5.6.1.3. Full Screen (Ekrani i plotë)

Klikoni tek opsioni “**Full Screen**” nga menyja e settings-it.




Figura 47. Opsioni “Full Screen”

Pasi të klikoni tek opsioni “**Full Screen**” ekrani juaj do të ketë pamje të plotë si në figurën e më poshtme.




Figura 48. Aktivizimi i ekranit të plotë

5.6.1.4. Captions

Ky funksion ju mundëson që gjithçka që flitet në takim të paraqitet me shkrim me anë të titrave të drejtpërdrejta. Fillimisht duhet të klikoni tek butoni “**Captions**” nga menyja e settings-it.




Figura 49. Opsioni “Captions”

Pastaj do të ju hapet një dritare nga e cila ju mund të zgjidhni në cilën gjuhë të shfaqen titrat dhe pastaj e shtypni butonin “**Apply**”.




Figura 50. Opsionet për zgjedhjen e gjuhës

Pastaj çka do që ju flisni do të jetë edhe në formën e shkruar posht si titra, në rastin tonë në gjuhën angleze pasi e kemi përzgjedhur më parë.




Figura 51. Aktivizimi i titrave

Ekziston mundësia për aktivizimin dhe ndalim e paraqitjes së titrave, nëse klikoni mbi ikonën e titrave atëher ndalon së paraqituri titrat në takim.



Figura 52. Çaktivizimi i titrave

5.6.1.5. Report a problem (Raporto një problem)

Nëse përballeni me ndonjë problem duke përdorur “Google Meet”, mund ta raportoni këtë problem tek Google. Pasi të klikoni tek butoni “**Report a problem**” nga menyja e settings-it, do të ju shfaqet një dritare që ju kërkon ta ndani ekranin dhe të tregoni çfarë problemi keni dhe të ja dërgoni atë ekipit të Google-së.




Figura 53. Raportimi i një problemi

5.6.1.6. Settings

Nëse dëshironi që të kontrolloni dhe rregulloni audio-në dhe video-në këtë mund ta bëni nga opsioni “Settings”.




Figura 54. Audio/video settings

Pasi të klikoni në opsionin “Settings” do të ju hapet një dritare nga ku mund të rregulloni audio-në dhe video-në.

Tek pjesa Audio ju mund ta rregulloni dhe të provoni nëse zëri juaj është në rregull.




Figura 55. Audio settings

Gjithashtu tek pjesa Video ju mund ta provoni kamerën tuaj, dhe të zgjidhni rezulucionin e ekranit që ju përshtatet më së miri.




Figura 56. Video settings

5.6.2. Present now

Google Meet ju lejon të ndani ekranin tuaj, një dritare të veçantë ose një dritare nga Google Chrome për pjesmarrsit tuaj në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Fillimisht klikoni tek opsioni “**Present now**” në pjesën e poshtme të ekranit pastaj do të ju shfaqet një dritare e cila ju siguron opsione të ndryshme të ndarjes së ekranit tuaj:




Figura 57. Opsioni Present now

Your entire screen – ju mundëson të ndani ekranin tuaj dhe të paraqini sllajde.

A window – mundëson ndarjen e vetëm një dritareje të veçantë të aplikacionit.





Figura 58. Present now – Winodws selection

Pastaj zgjedheni dritaren e dëshiruar nga opsionet e ofruara, klikoni në butonin “Share” dhe ajo dritare do të ndahet me të gjithë pjesëmarrësit në thirrjen e drejtpërdrejtë.



Present now – Winodws selection

Pastaj zgjedheni dritaren e dëshiruar nga opsionet e ofruara, klikoni në butonin “Share” dhe ajo dritare do të ndahet me të gjithë pjesëmarrësit në thirrjen e drejtpërdrejtë.




Figura 59. Ndarja e një dritarje

A chrome tab – ky opsion mundëson ndarjen e një dritareje të vetme nga Chrome.




Figura 60. Ndarja e një dritareje nga Chrome

Zgjidhni dritaren të cilën dëshironi ta ndani me pjesmarrsit e tjerë në takim pastaj shtypni butoni “Share”, dhe dritarja do të ndahet me të tjerët.




Figura 61. Ndarja e dritarë nga chrome

5.6.3. Rejoin Meeting (Bashkohu përsëris në takim)

Pasi të përfundoni takimin, Google Meet ju pyet edhe një herë nëse doni të ribashkoheni në takim, (në rast se jeni larguar aksidentalisht nga takimi) apo jo.




Figura 62. Bashkohu përsëris në takim

Nëse klikoni tek butoni “**Rejoin**”, do të ktheheni përsëris në takim. Përndryshe nëse klikoni në butonin “**Return to home screen**” ktheheni në faqen kryesore të Google Meet. (Khalid, n.d.)

6. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

6.1. Dizajnimi i hulumtimit

Hulumtimi është realizuar me anë të metodologjisë cilësore dhe sasiore. Për mbledhjen e të dhënave janë përdorur pyetësorët që janë përpiluar për studentët dhe intervistat për profesorët. Si dhe literatura e hulumtuar. Pyetjet si në pyetësorë ashtu edhe në intervista janë të strukturuar mirë dhe qartë, në mënyrë që të jenë sa më të kuptueshme, që studentët dhe profesorët të shprehin mendimet e tyre në mënyrë të qartë dhe të sigurtë. Kërkimi sasior ofron mundësinë e marrjes së informacionit statistikor rreth pyetjeve kërkimore, i cili na ndihmon të arrijmë në konkludime të sakta. Natyra e të dhënave lejon, ndër të tjera, zbatimin e testeve të ndryshme statistikore me qëllim testimin e hipotezave dhe si rrjedhojë nxjerrjen e përfundimeve rreth tyre.

6.2. Populacioni dhe mostra

Metodat kryesore që përdoren për të zgjedhur një kampion mbi të cilin kryhet vërtetimi janë metodat probabilitare të zgjedhjes dhe metodat joprobabilitare.

Sipas metodave probabilitare të zgjedhjes çdo njësi vërtetimi ka të njëjtin probabilitet për t'u zgjedhur. Në zgjedhjen joprobabilitare supozohet që ka një shpërndarje të barabart të karakteristikave të popullatës. Ndërsa, në zgjedhjen probabilitare karakteristika e procesit të zgjedhjes është zgjedhja e rastësishme, dhe jo supozimi rreth strukturës së popullatës. Meqë në zgjedhjen joprobabilitare të secilit element që mund të përfshihet në zgjedhje. Metoda e zgjedhjes së kampionit që është përdorur në këtë hulumtim është kampioni joprobabilitar (i qëllimshëm). Në këtë hulumtim populacionin apo grupin reprezentativ e përbëjnë studentët e nivelit master. Duke pasur parasysh numrin e madh të departamenteve kemi përzgjedhur vetëm dy departamente. Pra për realizimin e këtij punimi si mostër janë marrë studentët e nivelit master të Universitetit "Hasan Prishtina", nga Fakulteti i Edukimit përkatësisht nga Programet "Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK" si dhe "Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë".

Numri i studentëve që janë përfshirë për plotësimin e pyetësorit është 72, 19 student nga viti i dytë i studimeve dhe 53 student nga viti i parë i studimeve. Dhe janë intervistuar 5 profesor, 3 profesor nga departamenti i "Teknologjisë me TIK" dhe 2 profesor nga departamenti i "Matematikës".

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës apo pjesëmarrësve

| Departamentet | Studentët | Gjinia | | | Moshë | | | | Viti i studimeve | |
|--|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------|----------|-----------|------------------|-------------|
| | t | S | F | M | 20-25 | 25-30 | 30-35 | 40+ | Viti i parë | Viti i dytë |
| Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK | 47 | 30 | 17 | 14 | 12 | 20 | 1 | 32 | 15 | |
| Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë | 25 | 21 | 4 | 6 | 11 | 4 | 3 | 21 | 4 | |
| Gjithsej | 72 | 51 | 21 | 20 | 23 | 24 | 4 | 53 | 19 | |

Tabela 2. Shpërndarja e mostrës sipas nivelit shkollor dhe gjinisë

| Viti i studimeve | Student | Femër | Mashkull |
|------------------|-----------|-----------|-----------|
| Viti i parë | 53 | 37 | 16 |
| Viti i dytë | 19 | 14 | 5 |
| Gjithsej | 72 | 51 | 21 |

6.3. Instrumentet

Në këtë hulumtim kemi përdorur teknikën e anketimit dhe si instrumente kryesore matëse janë: pyetësi për student dhe intervista për profesor, të cilat janë përpiluar për të mbledhur informacione, se cilat janë efektet e studimit nga distanca, a kanë hasur në vështirësi studentët dhe profesorët si dhe cilat platforma i kanë përdorur më së shumti dhe a kishin profesorët përgatitje adekuate për mbajtjen e mësimit nga distanca.

6.4. Procedurat

Të dhënat sasiore janë grumbulluar me anën e pyetësorëve të përpiluar për studentët, ndërsa të dhënat cilësore janë grumbulluar me anën e intervistave të zhvilluara me profesor dhe përmes literaturë së hulumtuar.

Në fazën e parë të zbatimit të hulumtimit kam diskutuar me profesorin mentor nëse pyetjet ishin në rregull, pas miratimit nga ana e profesorit, kam filluar aplikimin e hulumtimit. Pastaj i kam njoftuar studentët dhe profesorët për qëllimin e hulumtimit dhe ata me gjithë dëshirë ishin të gatshëm për të qenë pjesë e hulumtimit.

Në fazën e dytë i kam shpërndarë pyetësorët me studentët e përzgjedhur për hulumtim, ku përmes pyetësorit për student dhe intervistës për profesor është bërë një vlerësim mbi efektet e studimeve nga distanca si dhe përdorimin e platformave. Pasi kam përfunduar plotësimin e pyetësorëve me student, pjesa tjetër ka qenë realizimi i intervistave me profesorët e të dy departamenteve. Pesë profesor janë intervistuar për rrjedhjen dhe efektet që ka sjell procesi i të mësuarit nga distanca. Në fazën e tretë kam bërë analizimin e të dhënave të grumbulluara përmes pyetësorëve dhe intervistës, pastaj kam bërë sistemimin e përgjigjeve me programin Microsoft Excel dhe rezultatet e fituara i kam paraqitur në mënyrë grafike ndërsa testimin dhe vërtetimin e hipotezave e kam bërë me programin aplikativ SPSS.

7. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Sipas hulumtimit të realizuar, kemi nxjerrur rezultate rreth efekteve të studimeve nga distanca gjatë kohës së pandemisë.

Për këtë hulumtim kemi përdorur metodat deskriptive dhe krahasuese për përpunimin dhe interpretimin e të dhënave. Analizën e të dhënave e kemi bërë me programin SPSS dhe me testin T apo Independence Simple Test, i cili bënë krahasimin e dy mostrave të pa varura. Pra testi T i dy mostrave të pavarura bënë krahasimin e dy grupeve të ndryshme të mostrave, ku antarët e dy grupeve janë të ndarë nga njëri – tjetri.

Testi T përdoret për të hulumtuar se a ka dallim ndërmjet dy grupeve të mostrave për nga mesataret. Testi T përcakton se a ka dallim të konsiderueshëm mesatarja e një grupi me mesataren e grupit tjetër. Në testin T, pika kritike është “dy”. Testi T gjithmonë krahason dy mesatare apo dy vlera të ndryshme.

Teksa shqyrtohen dallimet e grupeve në nivelin e rëndësis në testin T, është e rëndësishme të kihen parasysh testet njëansore (one-tailed) dhe dy anësore (two-tailed). Në testin dy anësor, nuk është me rëndësi drejtimi pozitiv apo negativ i dallimit të mesatarës së një grupi për nga grupi tjetër. Por


në testin një anësor, në një drejtim të caktuar (pozitiv apo negativ), pritet që mesatarja e grupit të parë të jetë e ndryshme prej mesatarës së grupit të dytë. (Hameli, 2017)

Në vijim kemi paraqitur rezultatet e hulumtimit rreth pyetësorit me student dhe intervistës me profesor, pastaj vërtetimin e hipotezave të cilat i kemi testuar përmes programit SPSS.

7.1. Rrezultatet nga pyetësorët me studentët

Pyetja e parë: 1. A keni pasur pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia?

Studentët nga të dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 1.




Grafiku 1. A ishin studentët e pajisur me pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online?

Sipas rezultateve në grafikun 1, në pyetjen “A keni pasur pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 47 apo 65% prej tyre janë përgjigjur në opsionin “Po”, se ata kishin pajisje për mbajtjen e mësimit online nga shtëpit e tyre, gjithashtu studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 25 apo 35% prej tyre janë përgjigjur në opsionin “Po”, pra edhe ata kanë qenë të pajisur me pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia.

Do të thotë se në të dy departamentet, 72 apo 100% prej studentëve janë deklaruar se janë të pajisur me pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit nga shtëpia.

Pyetja e dytë: 2. A keni pasur një lidhje të qëndrueshme interneti në shtëpin tuaj për të ndjekur mësimin online nga shtëpia? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 2.




Grafiku 2. A kishin studentët lidhje të qëndrueshme interneti për mbajtjen e studimeve nga shtëpia?

Sipas rezultateve në grafikun 2, në pyetjen “A keni pasur një lidhje të qëndrueshme interneti në shtëpin tuaj për të ndjekur mësimin online nga shtëpia?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 36 apo 50% prej tyre janë përgjigjur në opsionin “Po”, 8 apo 11% prej tyre janë përgjigjur në opsionin “Mesatare”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Jo mirë” dhe asnjë me “Jo”, ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 18 apo 25% janë përgjigjur në opsionin “Po”, 6 apo 8% janë përgjigjur me opsionin “Mesatare”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Jo mirë”, dhe në opsionin “Jo” nuk ka as një përgjigje.

Nga ky grafik kuptojm se 54 apo 75% e studentëve kishin një linjë të qëndrueshme të internetit, 14 apo 19% e studentëve kishin një linjë mesatare të internetit, 4 apo 6% e studentëve kishin linjë jo të mirë. Nga ky grafik shihet se studentët në përgjithësi kishin një linjë të qëndrueshme të internetit për realizimin e ligjëratave nga shtëpia.

Pyetja e tretë: 3. Çfarë llojë pajisje keni përdorur për të zhvilluar mësimin online? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 3.




Grafiku 3. Cilat pajisje i kanë përdorur studentët për zhvillimin e mësimin online?

Sipas rezultateve në grafikun 3, në pyetjen “Çfarë llojë pajisje keni përdorur për të zhvilluar mësimin online?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 8 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “PC (Desktop)”, 41 apo 34% janë përgjigjur në opsionin “Loptop”, 2 apo 2% janë përgjigjur në opsionin “iPad/Tablet” dhe 30 apo 25% janë përgjigjur në opsionin “Telefon”, kurse studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 2 apo 2% janë përgjigjur në opsionin “PC (Desktop)”, 24 apo 20% janë përgjigjur në opsionin “Loptop”, asnjë nuk është përgjigjur në opsionin “iPad/Tablet”, dhe 13 apo 11% janë përgjigjur në opsionin “Telefon”.

Nga ky grafik kuptojm se 10 apo 9% kishin përdorur “PC (Desktop)” për zhvillimin e mësimin, 65 apo 54% kishin përdorur “Loptop”, 2 apo 2% kishin përdorur “iPad/Tablet” dhe 43 apo 36% kanë përdorur “Telefon”.

Pyetja e katërt: 4. A keni pasur vështirësi në përdorimin e platformave për mbajtjen e mësimit online? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 4.




Grafiku 4. A kishin studentët vështirësi në përdorimin e platformave?

Sipas rezultateve në grafikun 4, në pyetjen “A keni pasur vështirësi në përdorimin e platformave për mbajtjen e mësimit online?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 1 apo 1% është përgjigjur në opsionin “Po”, 41 apo 58% janë përgjigjur në opsionin “Jo”, dhe 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Ndonjëherë”, gjithashtu studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Po”, 18 apo 25% janë përgjigjur në opsionin “Jo”, dhe 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Ndonjëherë”.

Nga ky grafik kuptojm se 3 apo 4% e studentëve kishin vështirësi në përdorimin e platformave për mbajtjen e mësimit online nga distanca, 59 apo 82% nuk kishin vështirësi në përdorimin e platformave dhe 10 apo 14% e studentëve ndonjëherë kishin hasur në vështirësi për përdorimin e platformave për mbajtjen e mësimit.

Pyetja e pestë: 5. Cilat nga platformat e më poshtme i keni përdorur për realizimin e mësimit? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 5.




Grafiku 5. Përdorimi i platformave të ndryshme nga studentët.

Sipas rezultateve në grafikun 5, në pyetjen “Cilat nga platformat e më poshtme i keni përdorur për realizimin e mësimit?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 43 apo 25% janë përgjigjur për opsionin “Google Classroom”, 41 apo 24% janë përgjigjur për opsionin “Google Meet”, 4 apo 2% janë përgjigjur për opsionin “Zoom”, 35 apo 20% janë përgjigjur për opsionin “Blackboard”, ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 20 apo 12% janë përgjigjur në opsionin “Google Classroom”, 24 apo 14% janë përgjigjur për opsionin “Google Meet”, 4 apo 2% janë përgjigjur për opsionin “Zoom”, nërsa platformën Blackboard nuk e ka përdorur asnjë nga studentët e departamentit të Matematikës.

Nga ky grafik kuptojm se 63 apo 37% e studentëve e kishin përdorur platformën “Google Classroom”, 65 apo 38% e kishin përdorur platformën “Google Meet”, 8 apo 4% e kishin përdorur platformën “Zoom” dhe 35 apo 20% e kanë përdorur platformën “Blackboard”.

Pyetja e gjashtë: 6. A keni pasur në shtëpinë tuaj një hapësirë të qetë për të ndjekur mësimin online? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 6.




Grafiku 6. A kishin studentët hapësirë të qetë për ndjekjen e mësimin nga shtëpia?

Sipas rezultateve në grafikun 6, në pyetjen “A keni pasur në shtëpinë tuaj një hapësirë të qetë për të ndjekur mësimin online?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” u përgjigjën si në vijim, 27 apo 38% janë përgjigjur në opsionin “Në shumicën e rasteve”, 7 apo 10% janë përgjigjur në opsionin “Në pak raste”, 13 apo 18% janë përgjigjur në opsionin “Gjithmonë” dhe për opsionin “Asnjëherë” nuk kemi asnjë përgjigje. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim ku 15 apo 21% janë përgjigjur në opsionin “Në shumicën e rasteve”, 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Në pak raste”, 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Gjithmonë”, dhe në opsionin “Asnjëherë” nuk kemi marr asnjë përgjigje.

Nga ky grafik kuptojm se 42 apo 59% e studentëve “Në shumicën e rasteve” kanë pasur një hapësirë të qetë për mbajtjen e mësimin nga distanca, 12 apo 17% kishin një hapësirë të qetë “Në pak raste”, 18 apo 25% kishin hapësirë të qetë “Gjithmonë”, ndërsa asnjë student nuk është deklaruar se nuk ka pasur “Asnjëherë” një mjedis të qetë.

Pyetja e shtatë: 7. Cilën formë të mësimit online e keni përdorur më së shumti? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 7.




Grafiku 7. Cila është forma e mësimit online e praktikuar më së shpeshti?

Sipas rezultateve në grafikun 7, në pyetjen “Cilën formë të mësimit online e keni përdorur më së shumti?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “Video konferenca”, 35 apo 49% janë përgjigjur në opsionin “Ndjekja e ligjëratave, powerpoint me audio dhe video”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Lexim i pavarur i materialeve”. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 1 apo 1% është përgjigjur në opsionin “Video konferenca”, 22 apo 31% janë përgjigjur në opsionin “Ndjekja e ligjëratave, powerpoint me audio dhe video”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Lexim i pavarur i materialeve”.

Nga ky grafik kuptojm se 11 apo 15% kanë përdorur “Video konferencat” si formë të mësimit online, 57 apo 79% si formë mësimi kanë përdorur “Ndjekjen e ligjëratave, powerpoint me audio dhe video”, ndërsa 4 apo 6% si formë të mësimit e kanë përzgjedhur “Leximi i pa varur i materialeve”.

Pyetja e tetë: 8. Gjatë kohës sa e keni mbajtur mësimin online, a keni shpenzuar më tepër kohë në kryerjen e obligimeve si (ligjërata, mësimnxënie dhe kryerjen e detyrave)? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 8.




Grafiku 8. A kanë shpenzuar studentët më tepër kohë në kryerjen e obligimeve?

Sipas rezultateve në grafikun 7, në pyetjen “Cilën formë të mësimin online e keni përdorur më së shumti?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 18 apo 25% janë përgjigjur në opsionin “Shumë më tepër”, 6 apo 8% janë përgjigjur në opsionin “Shumë pak”, 6 apo 8% janë përgjigjur në opsionin “Më pak”, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “Njejtë”, 7 apo 10% janë përgjigjur në opsionin “Më tepër”. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Shumë më tepër”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Shumë pak”, 4 apo 6% janë përgjigjur në opsionin “Më pak”, 8 apo 11% janë përgjigjur në opsionin “Njejtë”, 6 apo 8% janë përgjigjur në opsionin “Më tepër”.

Nga grafiku 8 kuptojm se 23 apo 32% janë përgjigjur në opsionin “Shumë më tepër”, 8 apo 11% janë përgjigjur në opsionin “Shumë pak”, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “Më pak”, 18 apo 25% janë përgjigjur “Njejt”, si dhe 13 apo 18% janë përgjigjur se kanë shpenzuar “Më tepër” kohë për realizimin e obligimeve të studimeve.

Pyetja e nëntë: 9. Cilat janë efektet pozitive të mësimi online, të realizuar përmes platformave elektronike? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 9.




Grafiku 9. Efektet pozitive të mësimi online.

Sipas rezultateve në grafikun 9, në pyetjen “Cilat janë efektet pozitive të mësimi online, të realizuar përmes platformave elektronike?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 3 apo 3% janë përgjigjur “Interaktiviteti në mes të profesorëve dhe studentëve, materialet në formë elektronike, si dhe çasje më e shpejtë”, 42 apo 43% janë përgjigjur “Kursim në kohë dhe kosto”, 5 apo 5% janë përgjigjur “Mundësi për të punuar dhe studiuar në të njëjtën kohë”, 11 apo 11% janë përgjigjur “Përdorimi më i madh i teknologjive të komunikimit

dhe i platformave të ndryshme”, 1 apo 1% janë përgjigjur “Mundësi për shkëmbimin e literaturës me të tjerët”, 3 apo 3% janë përgjigjur “Mundësi për të mësuar në çdo vend dhe kohë, si dhe komoditeti më i madh”, 1 apo 1% është përgjigjur “Mundësia për dërgimin e detyrave online, pa pasur nevojë për dorzimin e tyre në kopje”, 1 apo 1% është përgjigjur “Qasja e shpejtë dhe e lehtë në literaturë”. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 2 apo 2% janë përgjigjur “Bashkëpunim më i shpejtë dhe më i lehtë”, 21 apo 21% janë përgjigjur “Kursim në kohë dhe kosto”, 1 apo 1% është përgjigjur “Mundësi për të punuar dhe mësuar në të njëjtën kohë”, 6 apo 6% janë përgjigjur “Përdorim më i madh i teknologjive të komunikimit dhe platformave të ndryshme”, dhe 1 apo 1% është përgjigjur “Mundësia për të mësuar në çdo vend dhe në çdo kohë”.

Nga grafiku numër 9 shohim se efektet pozitive të mësimin nga distanca janë të shumta, mirpo shohim se një ndër efektet pozitive që është vlerësuar më së shumti nga ana e studentëve ku 63 apo 64% kanë thënë se efekt pozitiv i mësimin nga distanca është “Kursimi në kohë dhe kosto”, kjo vjen si arsye pas studentët nuk kishin nevojë të udhëtonin nga qytetet e ndryshme drejt objektit të Fakultetit i cili ndodhet në qendër të Prishtinës. Ku nga kjo studentët kanë përfituar si në kohë ashtu edhe në kosto.

Pyetja e dhjetë: 10. Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 10.



Grafiku 10. Efektet negative të mësimit online.

Sipas rezultateve në grafikun 10, në pyetjen “Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 1 apo 1% është përgjigjur “Bashkëpunimi jo në nivel si me profesor, gjithashtu edhe me kolegë”, 2 apo 3% janë përgjigjur “Realizimi i ligjëratave gjatë kohës sa ne vetë ishim në procesin e mësimdhënies me nxënës”, 1 apo 1% është përgjigjur “Realizimi i mësimit online ka ndikuar në vlerësim më të dobët”, 1 apo 1% është përgjigjur “Më pak mundësi për aktivitete grupore”, 1 apo 1% është përgjigjur “Mos realizimi i detyrave praktike”, 5 apo 7% janë përgjigjur “Mungesa e interaktivitetit”, 3 apo 4% janë përgjigjur “Mungesa e përqendrimit”, 17 apo 23% janë përgjigjur “Probleme të ndryshme teknike si (internet i dobët, mungesa e energjis elektrike apo defekte me pajisje)”, 3 apo 4 % janë përgjigjur “Vështirësi në kuptimin e disa ligjëratave (si p.sh., Matematikë apo Vizatim Teknik)”, 17 apo 23% janë përgjigjur “Mungesa e

kontaktit fizik me profesor dhe koleg”, ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 2 apo 3% janë përgjigjur “Realizimi i mësimit online ka ndikuar në vlerësim më të dobët”, 1 apo 1% është përgjigjur “Mungesa e interaktivitetit”, 7 apo 9% janë përgjigjur “Mungesa e përqendrimit”, 11 apo 15% janë përgjigjur “Probleme të ndryshme teknike (internet i dobët, munges e energjisë elektrike apo defekte me pajisje)”, 1 apo 1% janë përgjigjur “Vështirësi në kuptimin e disa ligjëratave (si p.sh. Matematikë apo Vizatim Teknik)”, 1 apo 1% është përgjigjur “Mungesa e kontaktit fizik me profesor dhe koleg”.

Nga grafiku numër 10 shohim se ka mjaft efekte negative të cilat vijnë si rrjedhojë e të mësuarit nga distanca ku 28 apo 38% e studentëve janë përgjigjur se gjatë mbajtjes së mësimit online kishin “Probleme të ndryshme teknike (si internet i dobët, munges e energjis elektrike apo defekte në pajisje”, gjithashtu 18 apo 24% e studentëve ju “Mungonte kontakti fizik me profesor dhe me koleg”, 10 apo 14% treguan se kishin hasur në “Mungesë të përqendrimit”.

Pyetja e njëmbëdhjetë: 11. Sa efektiv është mësimi online në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në objektin e Fakultetit? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 11.




Grafiku 11. Sa efektiv është mësimi online?

Sipas rezultateve në grafikun 11, në pyetjen “Sa efektiv është mësimi online në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në objektin e Fakultetit?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “Jashtëzakonisht shumë efektiv”, 17 apo 24% janë përgjigjur në opsionin “Shumë efektiv”, 16 apo 22% janë përgjigjur në opsionin “Mesatarisht efektiv”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Aspak efektiv”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Pak efektiv”. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, 1 apo 1% është përgjigjur në opsionin “Jashtëzakonisht shumë efektiv”, 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “Shumë efektiv”, 19 apo 26% janë përgjigjur në opsionin “Mesatarisht efektiv”, ndërsa në opsionet “Aspak efektiv” dhe “Pak efektiv” nuk kemi marr asnjë përgjigje.

Nga grafiku 11 shohim se 11 apo 15% e studentëve janë përgjigjur në opsionin “Jashtëzakonisht shumë efektiv”, 22 apo 31% janë përgjigjur në opsionin “Shumë efektiv”, 35 apo 49% janë përgjigjur në opsionin “Mesatarisht efektiv”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Aspak efektiv”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “Pak efektiv”. Nga ky grafik mund të konstatojm se mësimi online ishte “Mesatarisht efektiv”.

Pyetja e dymbëdhjetë: 12. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 12.




Grafiku 12. Si e kanë vlerësuar studentët cilësinë e mësimit online?

Sipas rezultateve në grafikun 12, në pyetjen “Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, asnjë student nuk është përgjigjur në opsionin “1 (Pa mjaftueshëm)”, 3 apo 4% janë përgjigjur në opsionin “2 (Mjaftueshëm)”, 7 apo 10% janë përgjigjur në opsionin “3 (Mirë)”, 24 apo 33% janë përgjigjur në opsionin “4 (Shumë mirë)”, 13 apo 18% janë përgjigjur në opsionin “5 (Shkëlqyeshëm)”. Ndërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, asnjë student nuk është përgjigjur në opsionet “1 (Pa mjaftueshëm)” dhe “2 (Mjaftueshëm)”, 11 apo 15% janë përgjigjur në opsionin “3 (Mirë)”, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “4 (Shumë mirë)”, 4 apo 6% janë përgjigjur në opsionin “5 (Shkëlqyeshëm)”.

Nga grafiku 12 mund të themi se asnjë student nuk e ka vlerësuar cilësinë e mësimit “1 (Pa mjaftueshëm)”, 3 apo 4% të studentëve e kanë vlerësuar cilësinë e mësimit online me notë “2 (Mjaftueshëm)”, 18 apo 25% e kanë vlerësuar cilësinë e mësimit online me shkallën e tretë “3 (Mirë)”, 34 apo 47% e kanë vlerësuar cilësinë e mësimit me shkallën e katërt “4 (Shumë mirë)”, dhe 17 apo 24% janë përgjigjur për shkallën e pestë “5 (Shkëlqyeshëm)”

Pyetja e trembëdhjetë: 13. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do t'i vlerësonit aftësitë e profesorëve që përdorin mjete digjitale për realizimin e mësimit online? Studentët nga dy departamentet e Fakultetit të Edukimit janë përgjigjur si në grafikun 13.



Grafiku 13. Vlersimi i studentëve për aftësitë e profesorëve në përdorimin e mjeteve digjitale.

Sipas rezultateve në grafikun 13, në pyetjen “Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do t'i vlerësonit aftësitë e profesorëve që përdorin mjete digjitale për realizimin e mësimit online?”, studentët e departamentit të “Teknologjis me TIK” janë përgjigjur si në vijim, asnjë student nuk është përgjigjur në opsionin “1 (Pa mjaftueshëm)”, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “2 (Mjaftueshëm)”, 13 apo 18% janë përgjigjur në opsionin “3 (Mirë)”, 19 apo 26% janë përgjigjur në opsionin “4 (Shumë mirë)”, 13 apo 18% janë përgjigjur në opsionin “5 (Shkëlqyeshëm)”. Nërsa studentët e departamentit të “Matematikës” janë përgjigjur si në vijim, në opsionin e parë nuk është përgjigjur asnjë studentë, 2 apo 3% janë përgjigjur në opsionin “2 (Mjaftueshëm)”, 10 apo 14% janë përgjigjur në opsionin “3 (Mirë)”, 8 apo 11% janë përgjigjur në opsionin “4 (Shumë mirë)”, 5 apo 7% janë përgjigjur në opsionin “5 (Shkëlqyeshëm)”.

Nga grafiku 13 kuptojm se asnjë student nuk është përgjigjur në opsionin “1 (Pa mjaftueshëm)”, 4 apo 6% janë përgjigjur në opsionin “2 (Mjaftueshëm)”, 23 apo 32% janë përgjigjur në opsionin “3 (Mirë)”, 27 apo 38% e studentëve janë përgjigjur për shkallën e katërt, sipas tyre profesorët

kishin aftësi “4 (Shumë të mira)” për përdorimin e mjeteve digjitale, 18 apo 25% e studentëve janë përgjigjur në shkallën e pestë, ata vlerësuan se profesorët kishin aftësi të “5 (Shkëlqyeshme)” në përdorimin e mjeteve digjitale për realizimin e mësimit online.

7.2. Rezultatet nga intervista me profesorët

Intervistat me profesorët janë realizuar në dy departamente të Fakultetit të Edukimit, në Universitetin “Hasan Prishtina” në Prishtinë, përkatësisht në departamentin “Master i mësimit të lëndës me specializim në Teknologji me TIK” kanë marrë pjesë tre profesor si dhe “Master i mësimit të lëndës me specializim në Matematikë” kanë marrë pjesë dy profesor.

Intervistat e realizuara nga tre profesorët e departamentit “Teknologji me TIK”, i kemi paraqitur në vijim:

1. Në cilin department jeni të angazhuar ju si profesor?

P1: Jam i angazhuar në departamentin e “Teknologjis me TIK”

P2: Në departamentin e “Teknologjis me Tik”

P3: “Teknologji me TIK”

2. A keni marr më parë trajnime specifike sa i përket mbajtjes së mësimit online nga Fakulteti i Edukimit, para se të fillonit të mbanit mësimit online?

P1: Para se të fillonim të mbanim mësimit online, unë kisha ndjekur vetëm një trajnim për realizimin e mësimit online në mënyrë individuale, jo të organizuar nga Fakulteti.

P2: Jo, para se të fillonte mbajtja e mësimit online nuk kam pasur rast që të ndjek ndonjë trajnim për mbajtjen e mësimit online nga distanca.

P3: Jo, nuk kam marr ndonjë trajnim adekuat për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia.

3. Si i keni fituar njohuritë dhe shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale?

P1: Përgaditja akademike dhe puna profesionale më ka mundësuar që në mënyrë individuale ti fitoj shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale.

P2: Shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale i kam fituar në mënyrë individuale duke përdorur burime informative dhe literatur të ndryshme.

P3: Shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale i kam fituar në mënyrë autodidaktike.

4. Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet a ju ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimor nga distanca?

P1: Po, përdorimi i platformave Google Meet dhe Google Classroom, na ka lehtësuar mjaft menaxhimin e procesit mësimor, ku në ato platforma e kam ndarë literature me studentët, i kam paraqitur detyrat që studentët duhej ti realizonin si dhe kohën e dorëzimit, etj.

P2: Po, sepse platformat ishin mjaft të thjeshtat për tu përdorur, nga platforma Google Classroom i kam menaxhuar detyrat e studentëve, nëse ata kishin ndonjë problem në realizimin e ndonjë detyre ju ktheja përgjigje, ndarjen e literatures me student, vendosjen e rezultateve finale të notimit, etj.

P3: Po, përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet na ka ndihmuar mjaft shumë, platforma Google Classroom na ka mundësuar ndarjen e ligjeratave me student, vendosjen e detyrave, caktimin e kohës për dorzim si dhe kthimin e vlersimit për detyren e caktuar, njoftimin e studentëve në rast se ora e parashikuar nuk mund të mbahej, etj.

5. A i keni përdorur platformat elektronike edhe gjatë kohës kur mësimi zhvillohej në suaza të normalës, nëse po cilat dhe për çfarë arsye i keni përdorur?

P1: PO, pjesërisht vetëm në kuadër të kurseve që lidhen me shfrytëzimin e teknologjive të edukimit në arsim në programin Bachelor dhe Master.

P2: Po e kam përdorur platformën Blackboard në disa kurse për ngarkimin e materialeve për student, në mënyrë që ata ta kishin materialin e organizuar brenda një kursi dhe të mund të qaseshin në të kudo dhe nga çdo pajisje.

P3: Jo, nuk i kam përdorur platformat elektronike.

6. A keni pasur rastin përpara se ju vetë të mbanit mësimin online të merrnit pjesë në konferenca, ligjerata apo takime online?

P1: Po, kam pasur rastin disa herë që të marr pjesë në takime online, disa here edhe në ligjerata që zhvilloheshin jashtë shtetit.

P2: Jo, nuk kam pasur rasint të marr pjesë në ndonjë takim online.

P3: Po, kam pasur rastin të marrë pjesë në video konferenca si dhe ligjerata online.

7. A ndjeheshit të stresuar para se të fillonit të mbani mësimin online në ligjeratat e para?

P1: Po, isha i brengosur dhe pjesërisht i stresuar se si do të shkonte procesi i mësimin online.

P2: Po, normalisht ishte një sfidë e re si për mua, ashtu edhe për gjithë profesorët e tjerë dhe normalisht fillimi ishte më i vështirë pastaj, çdo gjë ishte në rregull.

P3: Po, stresohesha se mos rrjeti nuk do të më funksiononte si duhet, apo do të më ndërpritej energjia elektrike, etj.

8. A e keni menduar ndonjëherë se përveç studentëve ju mund të dëgjoheni edhe nga antarët e tjerë të familjeve të studentëve, dhe si jeni ndjerë për këtë?

P1: Po, e kam menduar, dhe për mua nuk ka pasur asnjë ndikim.

P2: PO, çdo herë e kam menduar dhe nuk jam ndjerë fare në siklet për këtë.

P3: Jo, nuk e kam menduar.

9. A ndjeheshit të stresuar se mos studentët mund të ju fotografojnë apo inçizojnë gjatë kohës sa ju ishit duke ligjeruar?

P1: Jo, fare nuk jam mirrë me këtë punë, qëllimi im ka qenë që ora të realizohej ashtu siç unë e kisha planifikuar, kamera ime ka qenë gjithmonë e hapurë dhe s'jam ndjer aspak i stresuar.

P2: Nuk kam qenë i stresuar, por kam menduar se mund të inçizohem apo fotografohem.

P3: Jo, nuk jam ndjer asnjëherë i stresuar.

10. A kishit një ambient të rahatshëm në shtëpin tuaj gjatë kohës sa mbanit mësim online?

P1: Po, që nga fillimi i mësimit online kam pasur një vend të rahatshëm në zyrën time në shtëpi.

P2: Në fillim të mësimit online nuk kisha një mjedis të rahatshëm, por pastaj e kam rregulluar.

P3: Po, që nga fillimi i mësimit online e kam pasur ambientin e rahatshëm, përshkak të hapsirës së madhe në shtëpi.

11. A keni hasur në vështirësi për diskutime interaktive me studentët?

P1: Po, vështirësia bazike ishte kur një student fillonte të diskutonte dhe unë nuk kisha mundësi të verifikoja nëse studentët e tjerë ishin aktiv, prandaj kam qenë i detyruar të vendosi një sistem komunikimi të rastësishëm për vendosjen e studentëve në interaktivitet.

P2: Jo, asnjëherë nuk kam hasur në vështirësi studentët gjithmonë kanë qenë aktiv dhe çdoherë që ja kam përmendur emrin studentët pahezituar janë qasur në diskutime.

P3: Po, për shkak se ndonjëherë disa student kishin linja të dobët interneti dhe nuk ishin aktiv në diskutime.

12. Në çmasë studentët u përgjigjën dhe i përmbushën detyrat që u janë dhënë?

P1: Studentët ishin të përgjegjshëm në obligimet e tyre ata i përmbushën detyrat në mënyrë të mjaftueshme.

P2: Pothuajse të gjithë studentët ishin të rregullt në realizimin dhe dërgimin e detyrave.

P3: Të gjithë studentët ishin të përgjegjshëm për punën e tyre dhe ata arritën në finalizimin dhe dorzimin e detyrave në kohën e duhur.

13. A ishin studentët të interesuar për mësimnxënie edhe gjatë mësimit online?

P1: Po, në të gjitha kurset që unë kam ligjeruar interesimi i studentëve ka qenë i lartë si në ligjerata, realizimin e detyrave, në aktivitete, punime, diskutime.

P2: Po, studentët ishin të interesuar për mësimnxënie online, ishin prezent dhe aktiv në ligjerata, i prezantonin punimet dhe bënë bashkëbisedim si me studentët e tjerë, ashtu edhe me mua si profesor, merrnin pjesë në aktivitet brenda ligjeratës, etj.

P3: Studentët gjatë mësimit online ishin mesatarisht të interesuar për mësimnxënie.

14. Si do t'i vlerësonit aftësitë e studentëve në përdorimin e mjeteve digjitale gjatë ligjeratave, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 minimumi, 5 maksimumi)?

P1: Studentët me të cilët unë kam punuar kanë paraqitur aftësi shumë të mira në përdorimin e mjeteve digjitale dhe unë do t'i vlersoja në shkallën 4.5.

P2: Në përgjithësi studentët e mi kanë pasur aftësi shumë të mira në përdorimin e mjeteve digjitale.

P3: Studentët, me të cilët unë kam punuar kanë pasur aftësi shumë të mira në përdorimin e mjeteve digjitale.

15. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online?

P1: Në përgjithësi procesi mësimor ka shkuar shumë mirë.

P2: Mendoj se cilësia e mësimit online nga shtëpia ishte e mirë.

P3: Në përgjithësi procesi mësimor ka shkuar shumë mirë.

16. Cilat ishin efektet pozitive të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

P1: Nuk mendoj se ka pasur efekte positive të mësimit të realizuar online nga ai në klasë, vetëm se gjatë kohës sa mbanim mësim online mund të qëndronim në mjedise shtëpiake dhe të ligjeronim paqenë prezent në objektin e Fakultetit.

P2: Efektet pozitive të mësimit online ishin kursimi në kohë, si dhe ligjërimi mund të bëhej nga çdo vend, vetëm me një pajisje dhe një linjë interneti.

P3: Efekti pozitiv i mësimit online të realizuar nga distanca ishte se ne mund të ndodheshim jashtë vendit dhe ti mbanim ligjeratat paasnjë penges, duke përdorur loptopin dhe duke shfrytëzuar një linjë interneti.

17. Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

P1: Efektet negative të mësimit online ishin se unë nuk mund ta dija nëse studentët janë duke e kuptuar atë që unë e shpjegoja pasi nuk i shihja fytyrat e tyre.

P2: Efektet negative ishin se ndonjëher kisha probleme me internetin, gjithashtu edhe studentët here pas here kishin problem me internetin, apo me pajisjet e tyre dhe kështu shkëputeshin nga ligjerata, apo nga prezantimi i detyrave.

P3: Efekt negativ ishte se disa student ndonjëher nuk qaseshin fare në ligjerata, ndonjëher studentët kishin probleme me internet ose me pajisje.

Intervistat e realizuara nga dy profesorët e departamentit të “Matematikës”, i kemi paraqitur në vijim:

1. Në cilin department jeni të angazhuar ju si profesor?

P1: Departamenti i Matematikës

P2: Departamenti Fillor dhe Departamentin lëndor të Matematikës.

2. A keni marr më parë trajnime specifike sa i përket mbajtjes së mësimit online nga Fakulteti i Edukimit, para se të fillonit të mbanit mësimit online?

P1: Jo, nuk kam mbajtur asnjë trajnim para se të fillonim mbajtjen e mësimit online nga distanca me student.

P2: Jo, nuk kam marr asnjë trajnim para se të fillonim mbajtjen e mësimit nga distanca.

3. Si i keni fituar njohuritë dhe shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale?

P1: Në mënyrë autodidakte si dhe ndonjëherë me ndihmën e antarëve të familjes.

P2: Në mënyrë autodidakte.

4. Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet a ju ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimor nga distanca?

P1: Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet na ka lehtësuar punën mjaftë shumë, pasi në platformën Google Classroom e ndanim materialin me studentët, bënim njoftime, postimin e detyrave, marrjen e detyrave, etj.

P2: Ka qenë e vetmja mundësi ta zhvillojm procesin mësimor na kan ndihmuar për dërgimin dhe marrjen e detyrave, ndarjen e materialit me student, njoftimet si dhe mbajtjen e ligjeratave.

5. A i keni përdorur platformat elektronike edhe gjatë kohës kur mësimi zhvillohej në suaza të normales, nëse po cilat dhe për çfarë arsye i keni përdorur?

P1: Jo, gjatë kohës sa mësimin e realizonim në klasa nuk i kam përdorur platformat elektronike asnjëherë.

P2: Jo, gjatë kohës sa mësimin e mbanim në objektin e fakultetit nuk i kam përdorur asnjë platform elektronike.

6. A keni pasur rastin përpara se ju vetë të mbanit mësimin online të merrnit pjesë në konferenca, ligjerata apo takime online?

P1: Jo nuk kam pasur rastin të isha pjesëmarrëse në ndonjë takim online.

P2: Po, takime me kolegë.

7. A ndjeheshit të stresuar para se të fillonit të mbani mësimin online në ligjeratat e para?

P1: Po, isha mjaftueshëm e stresuar se si do të shkonte ora, a do të kisha probleme me pajisje, etj.

P2: Jo, nuk isha i stresuar aspak.

8. A e keni menduar ndonjëherë se përveç studentëve ju mund të dëgjoheni edhe nga antarët e tjerë të familjeve të studentëve, dhe si jeni ndjerë për këtë?

P1: Jo, nuk mund të them se më ka ardhur ndonjëherë ky mendim.

P2: Po, e kam menduar por për mua nuk ka rëndësi, kushdo që ka interes mund të marr pjesë në ligjerata.

9. A ndjeheshit të stresuar se mos studentët mund të ju fotografojnë apo inçizojnë gjatë kohës sa ju ishit duke ligjeruar?

P1: Jo, asnjëherë nuk kam pasur mendime shqetësuese lidhur me mundësin e fotografimit apo inçizimit nga ana e studentëve.

P2: Jo, asnjëherë nuk jam ndjerë i stresuar në lidhje me këtë.

10. A kishit një ambient të rehatshëm në shtëpin tuaj gjatë kohës sa mbanit mësim online?

P1: PO, po thuajse çdo here kisha një mjedis të përshtatshëm.

P2: Po, fatmirësisht në shtëpi e kam pasur të rregulluar dhomën e punës.

11. A keni hasur në vështirësi për diskutime interaktive me studentët?

P1: Jo, të gjitha ligjeratat i kam ripërpunuar dhe i kam përgaditur për t'i zhvilluar në mënyrë online. Nuk kam hasur në vështirësi.

P2: Jo, studentët ishin aktiv dhe nuk kam hasur në ndonjë vështirësi për diskutime interaktive.

12. Në çmasë studentët u përgjigjën dhe i përmbushën detyrat që u janë dhënë?

P1: Në masë të kënaqshme.

P2: Studentët me të cilët unë kam punuar kanë qenë aktiv në çdo detyrë.

13. A ishin studentët të interesuar për mësimnxënie edhe gjatë mësimit online?

P1: Po, studentët ishin shumë të interesuar për mësimnxënie.

P2: Po, pothuajse të gjithë studentët ishin pjesëmarrës në ligjerata dhe ishin të interesuar për të mësuar edhe në këtë llojë mësimi.

14. Si do t'i vlerësonit aftësitë e studentëve në përdorimin e mjeteve digjitale gjatë ligjeratave, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 minimumi, 5 maksimumi)?

P1: Studentët në përgjithësi kishin aftësi të mira në përdorimin e mjeteve digjitale.

P2: Pothuajse të gjithë studentët kishin aftësi maksimale për përdorimin e mjeteve digjitale.

15. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online?

P1: Cilësia e mësimit online ishte në nivel të mirë.

P2: Cilësia e mësimit online ishte në nivel shumë të mirë.

16. Cilat ishin efektet pozitive të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

P1: Krahasuar me mësimin e realizuar në klasë nuk mendoj që ka ndonjë përparësi sa i përket aspektit të cilësisë së mësimit të zhvilluar.

P2: Mësimi nga distanca na ka mundësuar që mësimin ta zhvillojm nga çdo vend pa pasur nevoj të gjindemi në objektin e fakultetit, si dhe mundësin për konsultim në çdo kohë.

17. Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

P1: Mendoj se pjesa më negative është fakti që studentët kanë pasur mundësi që të kyçen në ligjerata dhe të mos jenë prezent aty gjithë kohës, meqë nuk e kishin të detyrueshme ti mbajnë kamerat e hapura.

P2: Mungesë e interaktivitetit gjatë orës (puna bashkëpunuese) sepse platforma Google Meet nuk na ka mundësuar punën në grupe pasi shfrytëzimi i këtij opsioni është me pagesë.

7.3. Testimi i hipotezave

Testimin e hipotezave e kemi bërë përmes programit SPSS, ku i kemi paraqitur rezultatet rreth hipotezave të ngritura në hulumtim. Pasi i kemi anketuar studentët e programit “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK”, dhe studentët e programit “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë”, të anketuarit i kemi ndarë në dy grupe dhe kemi shfrytëzuar testin e dy mostrave të pavarura apo Independent Samples Test, i cili përdoret për të hulumtuar se a ka dallim ndërmjet dy grupeve të mostrave për nga mesataret.

Për të testuar hipotezat e ngritura jemi bazuar në kolonën e nivelit të rëndësisë Sig. (2-tailed), e cila krahason dallimin ndërmjet mesatareve të dy grupeve dhe tregon se a janë të rëndësishme këto dallime në nivelin e rëndësisë prej 5%. Niveli i rëndësisë mund të shpjegohet edhe përmes konceptit të intervalit të besueshmërisë. Niveli i rëndësisë prej 5% shpreh intervalin e besueshmëris prej 95%. (Hameli, 2017)

Rezultatit e hipotezës kryesore përmes testit T, e kemi paraqitur si në vijim:

Tabela 3. Ndryshimi i mesatareve të Programeve

| Group Statistics | | | | | |
|---|--|----|------|-------------------|-----------------|
| | Departamentet | N | Mean | Std. Deviation | Std. Error Mean |
| Sa efektiv është mësimi online në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në objektin e Fakultetit? | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK | 46 | 2.37 | .997 | .147 |
| | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë | 26 | 2.73 | .533 | .105 |
| A keni marr trajnime specifike sa i përket mbajtjes së mësimin online nga Fakulteti i Edukimit, para se të fillonit të mbanit mësim online? | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK | 3 | 2.00 | .000 ^a | .000 |
| | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë | 2 | 2.00 | .000 ^a | .000 |
| a. t cannot be computed because the standard deviations of both groups are 0. | | | | | |

Sipas rezultateve të analizës, mesatarja e 46 studentëve pjesmarrës nga Programi “Master i mësimdhënies lëndore në specializimi në Teknologji dhe TIK” është 2.37, ndërsa mesatarja e 26 studentëve pjesmarrës nga Programi “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë” është 2.73. Pra ekziston një dallimi i rëndësishëm i dy institucioneve. Ndërsa nga pyetja e profesorëve e shohim se mesatarja është e njejt tek të dy programet, dhe nuk ka dallim ndërmejt mesatareve të të dy programeve.

Tabela 4. Analiza e të dhënave nga testi i pavarur i mostrave T-Test

| Independent Samples Test | | | | | | | | | |
|---------------------------------|---|------------|------------------------------|-----------|------------|-----------|------------|----------------|--------------|
| | Levene's Test for Equality of Variances | | t-test for Equality of Means | | | | | | |
| | F | Sig | t | df | S2T | MD | SED | 95% CID | |
| | | | | | | | | Lower | Upper |
| EVA | 10.504 | .002 | -1.711 | 70 | .092 | -.361 | .211 | -.782 | .060 |
| EVNA | | | -2.002 | 69.868 | .049 | -.361 | .180 | -.721 | -.001 |

Në tabelën 4 shihet se rezultati signifikantës S2T ($p = 0.092$), vlera e saj është më e madhe se 0.05 dhe nuk është brenda intervalit të besueshmërisë prej 95%. Në këtë mënyrë, na refuzohet hipoteza kryesore:

- ✓ Efekti i studimeve nga distanca është në nivel të mirë, përkundër mospërgatitjes paraprake të profesorëve.

Pra, sipas rezultateve të testit T, studentët e të dy programeve nuk pajtohen me mendimin se “Efekti i studimeve nga distanca është në nivel të mirë, përkundër mos përgatitjes paraprake të profesorëve”.

Rezultatit e hipotezës ndihmëse përmes testit T, është paraqitur si në vijim:

Tabela 5. Ndryshimi i mesatareve të programeve

| Group Statistics | | | | | |
|--|--|---|--------|----------------|-----------------|
| | Departamentet | N | Mean | Std. Deviation | Std. Error Mean |
| Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet a ju ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimor nga distanca? | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK | 3 | 1.0000 | .00000 | .00000 |
| | Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë | 2 | 3.5000 | .70711 | .50000 |

Sipas rezultateve të analizës, mesatarja e 3 profesorëve nga Programi “Master i mësimdhënies lëndore në specializim në Teknologji me TIK” është 1.0000, ndërsa mesatarja e 2 profesorëve nga Programi “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë” është 3.5000. Pra, ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të të dy programeve.

Tabela 6. Analiza e të dhënave nga testi i pavarur i mostrave T-Test

| Independent Samples Test | | | | | | | | | |
|--------------------------|---|-----|------------------------------|-------|------|-------------|--------|---------|----------|
| | Levene's Test for Equality of Variances | | t-test for Equality of Means | | | | | | |
| | F | Sig | t | df | S2T | MD | SED | 95% CID | |
| | | | | | | | | Lower | Upper |
| EVA | | | -6.708 | 3 | .007 | 2.5000 0 | .37268 | 3.68603 | -1.31397 |
| EVNA | | | -5.000 | 1.000 | .126 | 2.5000 0 | .50000 | 8.85310 | 3.85310 |

Në tabelën 6 shihet se rezultati i signifkantes S2T ($p = 0.007$) tregon se ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet mesatareve të dy grupeve pra, vlera e saj është më e vogël se 0.05 dhe është brenda intervalit të të besueshmëris prej 95%. Në këtë mënyrë pranohet hipoteza ndihmëse:

- ✓ Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimorë nga distanca.

Pra, sipas rezultateve të testit T, profesorët e Programeve “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK” si dhe “Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë” pajtohen me mendimin se “Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimorë nga distanca”.

8. DISKUTIMI DHE KONKLODIMET

Qëllimi i këtij studimi ishte të hulumtonim për efektet e studimeve nga distanca duke përdorur platformat interaktive, cili ishte efekti i tyre në procesin e të mesuarit nga distanca gjatë kohës së pandemis të quajtur Covid-19.

Sipas këtij hulumtimi dhe sipas studimeve të bëra nga autor të ndryshëm, efektet e studimeve nga distanca janë pozitive por në të njëjtën kohë ka edhe efekte negative. Pra, zhvillimi i mësimin online nga distanca është realizuar duke përdorur teknologji dhe platforma të ndryshme të cilat i kanë zhvilluar aftësit e studentëve dhe profesorëve për përdorimin e tyre, e kanë bërë mësimin më atraktiv, kanë mundur që mësimin ta zhvillojnë nga çdo vend dhe në çdo kohë, çasjen në literatur kurdo që studentët kanë pasur nevoj, incizimin e ligjëratave dhe rishikimin e tyre disa herë deri sa ta kishin të kuart mësimin, ejt. Por gjithashtu zhvillimi i mësimin nga distanca kishte edhe mangësit e tij, nuk lejonte punën në grupe, probleme me internetin, probleme me pajisje, ejt.

Pyetja kryesore hulumtuese për të cilën kemi marrë përgjigje është:

1. Çfarë efekte ka studimi nga distanca përmes platformave tek studentët e nivelit mastër?

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek pyetsori me student (faqe 71 – 74, tek pyetja numër 9 dhe 10) dhe tek intervista me profesorët (faqe 82, dhe 85-86, tek pyetja numër 16 dhe 17), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

***Studentët:** “Në të dy departamentet në pyetjen e 16, ndër shumë efekte të tjera pozitive, 63 apo 64% e studentëve kanë thënë se efekti më pozitiv i mësimin nga distanca është “Kursimi në kohë dhe kosto” kjo vjen si arsytim pasi studentët nuk kishin nevoj të udhëtonin nga qytetet e ndryshme drejt objektit të Fakultetit i cili gjindet në qendër të Prishtinës për ndjekjen e ligjëratave. Gjithashtu në pyetjen e 17 studentët kanë thënë se kishin hasur edhe në efekte negative gjatë studimeve nga distanca, ku 20 apo 38% e studentëve janë përgjigjur se gjatë zhvillimit të mësimin*

online kishin “Probleme të ndryshme teknike (si internet i dobët, munges e energjis elektrike apo defekte në pajisje”, gjithashtu 18 apo 24% e studentëve kanë thënë se ju mungonte kontakti fizik me profesor dhe me koleg”.

Profesorët: “Në të dy departamentet profesorët kanë thënë se efekt pozitiv i të mësuarit nga distanca ishte se mësimin mund ta zhvillonin kudo që ishin, ju nevojitej vetëm një hapësirë e qetë, një pajisje dhe lidhje interneti për qasje në platform, ndërsa efektet negative ishin të natyrave të ndryshme pasi gjatë ligjëratave nuk mund të zhvillonin punën në grupe, studentët nuk ishin të detyruar ti linin kamerat e hapura ata ndoshta nuk kanë qenë të pranishëm në takim gjatë gjithë kohës, mungesa e përqendrimit nga ana e studentëve, probleme me internet dhe me pajisje”.

Pyetjet ndihmëse për të cilat kemi marrë përgjigje janë:

a) Sa posedojnë studentët njohuri dhe kushte të mjaftueshme për mbajtje të mësimit nga distanca?

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek pyetësi me student (faqe 63 dhe 64, tek pyetja numër 1 dhe 2), dhe tek intervista me profesor (faqe 81-82 dhe 85, tek pyetja numër 14), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

Studentët: “Studentët e të dy departamenteve tek pyetja 1 janë përgjigjur 72 apo 100% kanë thënë se janë të pajisur me pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia, ndërsa tek pyetja 2, 54 apo 75% e studentëve kishin pohuar se kishin një linjë të qëndrueshme interneti”.

Profesorët: “Profesorët e dy departamenteve kanë pohuar se student me të cilët ata kanë mabjtur mësim kanë paraqitur aftësi shumë të mira në përdorimin e mjeteve digjitale”.

b) A kanë profesorët nivel të duhur të përgatitjes për mësime nga distanca?

Përgjigjet për këtë pyetje gjenden tek pyetësi me student (faqe 77, tek pyetja numër 13), dhe tek intervista me profesor (faqe 78 dhe 83), të cilat i kemi paraqitur si në vijim:

Studentët: “Studentët e dy departamenteve tek pyetja e 13 janë përgjigjur kështu 27 apo 38% e studentëve kanë thënë se profesorët kishin aftësi shumë të mira për zhvillimin e mësimit nga distanca, 23 apo 32% janë përgjigjur në opsionin se profesorët kishin aftësi të mira, 18 apo 25%

e studentëve kanë thënë se profesorët kishin aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e mjeteve digjitale”.

Profesorët: *“Profesorët e dy departamenteve tek pyetja 2, kanë thënë se ata nuk kanë marrë asnjë trajnim për mbajtjen e mësimit online nga Fakulteti i Edukimit”.*

c) Sa është niveli i interesimit për mësimmxënie tek studentët në këto rrethana?

Përgjigja për këtë pyetje gjendet tek intervistat me profesor (faqe 81 dhe 85), të cilën e kemi paraqitur në vijim:

Profesorët: *“ Profesorët e të dy departamenteve kanë thënë se studentët e tyre kishin interesim të lartë për ndjekjen e ligjëratave, reazlimin e detyrave, aktivitete, punime, diskutime”.*

Hipotezat e hulumtimit për të cilat kemi marrë përgjigje janë:

Hipoteza kryesore:

- ✓ ***Efekti i studimeve nga distanca është në nivel të mirë, përkundër mospergatitjes paraprake të profesorëve.***

Vërtetimi i hipotezës kryesore gjendet tek pyetësi me studentët (faqe 75, pyetja e 11) dhe intervista me profesorët (faqe 78 dhe 83, si dhe tek tabela nr.4 faqe 88), e vërtetuar në programin SPSS me analizën T-test, të cilën e kemi paraqitur si në vijim:

“Rezulati i signifikatës S2T ($p = 0.092$) tregon se hipoteza kryesore nuk është vërtetuar pasi vlera e saj është më e madhe se 0.05 dhe nuk është brenda intervalit të besueshmërisë prej 95%. Pra në të dy departamentet 35 apo 49% e studentëve janë përgjigjur se mësimi online ishte mesatarisht efektiv, ndërsa të gjithë profesorët janë deklaruar se nuk kanë marrë asnjë trajnim nga Fakulteti i Edukimit”.

Hipoteza ndihmëse:

- ✓ *Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimorë nga distanca.*

Vërtetimi i hipotezës ndihmëse gjendet tek intervista me profesor (faqe 79 dhe 83, tek pyetja numër katër), e vërtetuar në programin SPSS me analizën T-test, të cilën e kemi paraqitur si në vijim:

“Rezultati i signifikantes S2T ($p = 0.007$) tregon se hipoteza alternative është vërtetuar sepse vlera e saj është më e vogël se 0.05 dhe është brenda intervalit të besueshmërisë prej 95%. Pra profesorët e të dy departamenteve kanë thënë se përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimor nga distanca”.

Në përfundim mund të themi se efektet e studimeve nga distanca nuk janë në nivel të mirë. Studentët dhe profesorët e pranojnë se studimi nga distanca ka efekte pozitive, por gjithashtu nuk mungojn edhe efektet negative.

Andaj, rezultatet e nxjerra nga ky hulumtim tregojnë se studentët kishin njohuri dhe pajisje për zhvillimin e mësimin online nga distanca, gjithashtu studentët kishin interesim të lartë për të marr pjesë në ligjerta dhe aktivitete të cilat zhvilloheshin online, platformat elektronike ju a kishin lehtësuar punën profesorëve pasi profesorët përmes platformave e ndanin materialin me studentët e tyre, i dërgonin dhe i pranonin detyrat, jepnin informacione, ejt.

REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Bijeesh, N. A. (a.d.). *Advantages and Disadvantages of Distance Learning*. Gjetur në INDIAEDUCATION:<https://www.indiaeducation.net/online-education/articles/advantages-and-disadvantages-of-distance-learning.html>
- Bukola, O. (2018, August 07). *Time for a refresh: Meet the new Google Classroom*. Gjetur në Google: <https://www.blog.google/outreach-initiatives/education/time-refresh-meet-new-google-classroom/>
- CPC. (2020). *Udhëzim i detajuar për Google Classroom*. CPC.
- Diaz, M. M., & Lee, C. (2020). *What technology can and can't do for education*. Inter-American Development Bank. .
- Edwards, L. (2021, March 19). *What is Google Classroom?* Gjetur në Tech & Learning: <https://www.techlearning.com/features/what-is-google-classroom>
- Ellis, R. K. (2009). *A field guide to Learning Management System*. American Society for Training & Development (ASTD).
- FAO. (2011). *E-learning methodologies: A guide for designing and developing e-learning courses*. Rome.
- Hameli, K. (2017). *Teknikat statistikore me shumë ndryshore me aplikim në SPSS*. Stamboll.
- Harting, K., & Erthal, M. J. (a.d.). History of Distance Learning. *Information Technology, Learning, and Performance Journal*.
- Hockenson, L. (2015, August 24). *Google Classroom updates with Calendar integration, new teacher tools*. Gjetur në TNW: <https://thenextweb.com/news/google-classroom-back-2-school>
- Huang, R, H., Liu, D, J., A, Yang, . . . et al. (2020). *Handbook on Facilitating Flexible Learning During Educational Disruption: The Chinese Experience in Maintaining Undisrupted Learning in COVID-19 Outbreak*. Beijing: Smart Learning Institute of Beijing Normal University.

- Ibrahim, A., Al-Kaabi, A., & El-Zaatari, W. (2013). Teacher resistance to educational change in the United Arab. *International Journal of Research Studies in Education*, 25-36.
- Johnston, S. (2017, March 09). *Meet the new Hangouts*. Gjetur në Google: Google Hangouts Meet, or just Meet, gives educators face-to-face time with their students - the best alternative to teaching from a physical classroom. With Hangouts Meet, schools can maintain the flow of communication - between students, parents, guardia
- Kahn, J. (2014, August 12). *Google Classroom now available to all Apps for Education users, adds collaboration features*. Gjetur në 9TO5Google: <https://9to5google.com/2014/08/12/google-classroom-now-available-to-all-apps-for-education-users-adds-collaboration-features/>
- Khalid, M. (a.d.). *Training Manual*. Gjetur në Google Meet: <https://lms.iiu.edu.pk/meet.pdf>
- Knerl, L. (2021, April 11). *Google Classroom: A Complete Review for Educators*. Gjetur në Hp Store: <https://www.hp.com/us-en/shop/tech-takes/google-classroom-review-educators>
- Magid, L. (2014, May 6). *Google Classroom Offers Assignment Center for Students and Teachers*. Gjetur në Forpages: <https://www.forbes.com/sites/larrymagid/2014/05/06/google-classroom-offers-control-center-for-students-and-teachers/?sh=4f778daf4d66>
- McGinnis, K. (2021, May 26). *Teachers' Essential Guide to Google Classroom*. Gjetur në Common sense education: <https://www.commonsense.org/education/articles/teachers-essential-guide-to-google-classroom>
- NEO. (2021, April 10). Gjetur në Google Tools for Education: https://www.neolms.com/info/google_tools_for_education
- Nguyen, T. P. (2019). ROLES OF E-LEARNING IN HIGHER EDUCATION. *Journal of Critical Reviews*.
- Papadopoulou, A. (2020, June 23). *What is Distance Learning? Definitions, Examples & More*. Gjetur në LearnWorlda: <https://www.learnworlds.com/distance-learning/>

- Perez, S. (2017, February 28). *Google quietly launches Meet, an enterprise-friendly version of Hangouts*. Gjetur në TC: https://techcrunch.com/2017/02/28/google-quietly-launches-meet-an-enterprise-friendly-version-of-hangouts/?guccounter=1&guce_referrer=aHR0cHM6Ly9lbi53aWtpcGVkaWEub3JnLw&guce_referrer_sig=AQAAAFNaNkM1h75RQtEzleR-zvO7amb0j0LJGZUz1nD39PwY2ebKMly5kfoz0kFVI8re
- Ressler, G. (2017, Mars 15). *Google Classroom: Now open to even more learners*. Gjetur në Google: <https://blog.google/outreach-initiatives/education/google-classroom-now-open-even-more-learners/>
- Roffe, I. (2004). *Innovation and e-Learning*. Printed in Great Britain by Cambridge Printing, Cambridge.
- Simon, J. (2021). *What is Distance Learning? The Complete Guide (2021)*. Gjetur në TechSmith: <https://www.techsmith.com/blog/distance-learning/>
- Simon, K. (2021, January 29). *Advantages and Disadvantages of Google Meet*. Gjetur në ProfPlus: <https://www.profolus.com/topics/advantages-and-disadvantages-of-google-meet/>
- Stanton, W. (2021, April 11). *How to create a google meet account*. Gjetur në alphr: <https://www.alphr.com/create-google-meet-account/>
- Universiteti "Nënë Tereza". (2018). *Doracak për studentë: Google Classroom*. Shkup.
- Yeskel, Z. (2020, April 09). *New Meet features to improve distance learning*. Gjetur në Google: <https://www.blog.google/outreach-initiatives/education/meet-for-edu/>

SHTOJCA A: PYETËSORI PËR STUDENT

- 1. Cila është gjinia juaj?**
 - a) Femër
 - b) Mashkull

- 2. Cila është mosha juaj?**
 - a) 20-25
 - b) 25-30
 - c) 30-35
 - d) Tjetër_____

- 3. Në cilin drejtim jeni duke i ndjekur studimet?**
 - a) Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK
 - b) Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë

- 4. Në cilin vitë të studimeve jeni aktualisht?**
 - a) Viti i parë i studimeve mastër
 - b) Viti i dytë i studimeve mastër

- 5. A keni pasur pajisje elektronike për mbajtjen e mësimit online nga shtëpia?**
 - a) Po
 - b) Jo

- 6. A keni pasur një lidhje të qëndrueshme interneti në shtëpinë tuaj për të ndjekur mësimin online?**
 - a) Po
 - b) Mesatare
 - c) Jo mirë
 - d) Jo

- 7. Çfarë llojë pajisje keni përdorur për të zhvilluar mësimin online?**
 - a) PC (Desktop)
 - b) Loptop
 - c) iPad/Tablet
 - d) Telefon

8. A keni pasur vështirësi në përdorimin e platformave për mbajtjen e mësimit online?

- a) Po
- b) Jo
- c) Ndonjëherë

9. Cilat nga platformat e më poshtme i keni përdorur për realizmin e mësimit?

- a) Google Classroom
- b) Google Meet
- c) Zoom
- d) Blackboard
- e) Tjetër _____

10. A keni pasur në shtëpinë tuaj një hapësirë të qetë për të ndjekur mësimin online?

- a) Në shumicën e rasteve
- b) Në pak raste
- c) Gjithmonë
- d) Asnjëherë

11. Cilën formë të mësimit online e keni përdorur më së shumti?

- a) Video konferenca
- b) Ndjekja e ligjëratave, powerpoint me audio dhe video
- c) Lexim i pavarur i materialeve

12. Gjatë kohës sa e keni mbajtur mësimin online, a keni shpenzuar më tepër kohë në kryerjen e obligimeve të studimeve si (ligjëratat, mësimmxënie dhe kryerjen e detyrave).

- a) Shumë më tepër
- b) Shumë pak
- c) Më pak
- d) Njejt
- e) Më tepër
- f)

13. Cilat janë efektet pozitive të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

14. Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?

15. Sa efektiv është mësimi online në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në objektin e Fakultetit?

- a) Jashtëzakonisht shumë efektiv
- b) Shumë efektiv
- c) Mesatarisht efektiv
- d) Aspak efektiv
- e) Pak efektiv

16. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta) si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online?

- a) 1 (Pa mjaftueshëm)
- b) 2 (Mjaftueshëm)
- c) 3 (Mirë)
- d) 4 (Shumë mirë)
- e) 5 (Shkëlqyeshëm).

17. Në shkallën prej 1 deri në 5 (1 minimumi, 5 maksimumi) si do t'i vlerësonit aftësitë e profesorëve që përdorin mjete digjitale për realizmin e mësimit online?

- a) 1 (Të pa mjaftueshme)
- b) 2 (Të mjaftueshme)
- c) 3 (Të mira)
- d) 4 (Shumë të mira)
- e) 5 (Të shkëlqyeshme)

SHTOJCA B: INTERVISTA PËR PROFESOR

- 1. Në cilin departament jeni të angazhuar ju si profesor?**
- 2. A keni marr trajnime specifike sa i përket mbajtjes së mësimit online nga Fakulteti i Edukimit, para se të fillonit të mbanit mësime online?**
- 3. Si i keni fituar njohuritë dhe shkathtësitë për përdorimin e teknologjive digjitale?**
- 4. Përdorimi i platformave Google Classroom dhe Google Meet a ju ka lehtësuar punën për menaxhimin e procesit mësimor nga distanca? Pse?**
- 5. A i keni përdorur platformat elektronike edhe gjatë kohës kur mësimi zhvillohej në suaza të normalës, nëse po cilat dhe për çfarë arsye i keni përdorur?**
- 6. A keni pasur rastin përpara se ju vetë të mbanit mësime online të mirrnit pjesë në konferenca, ligjërata apo takime online?**
- 7. A ndjeheshit të stresuar para se të fillonit të mbani mësimin online në ligjeratat e para?**
- 8. A e keni menduar ndonjëherë se pos studentëve ju mund të dëgjoheni edhe nga antarët e tjerë të familjeve të studentëve, dhe si jeni ndjerë për këtë?**
- 9. A ndjeheshit të stresuar se mos studentët mund të ju fotografojnë apo inçizojnë gjatë kohës sa ju ishit duke ligjëruar?**
- 10. A kishit një ambient të rehatshëm në shtëpinë tuaj gjatë kohës sa mbanit mësime online?**
- 11. A keni hasur në vështirësi për diskutime interaktive me studentët?**
- 12. Në çmasë studentët u përgjigjën dhe i përmbushën detyrat që u janë dhënë?**
- 13. A ishin studentët të interesuar për mësimnxënie edhe gjatë mësimit online?**
- 14. Si do t'i vlerësonit aftësitë e studentëve në përdorimin e mjeteve digjitale gjatë ligjëratarave, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 minimumi, 5 maksimumi)?**

- 15. Si do ta kishit vlerësuar cilësinë e mësimit online, në shkallën prej 1 deri në 5 (1 më e ulta, 5 më e larta)?**
- 16. Cilat janë efektet pozitive të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?**
- 17. Cilat janë efektet negative të mësimit online, të realizuar përmes platformave elektronike?**